# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5583
E shtunë, 22 shtator 2018
çmimi 0.40 €


## Delawie: Kosova e Serbia të arrijnë marrëveshje të qëndrueshme

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAFER GASHI FAQE 4-5



# Asociacioni i Komunave Serbe të jetë i njëjtë me asociacionin tonë

Zëvendëskryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), njëherësh kryetar i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, e ka quajtur të panevojshëm themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Megjithatë, ai ka thënë se edhe nëse ky asociacion bëhet duhet t'i ketë kompetencat e njëjta me Asociacionin e Komunave të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka theksuar se asociacioni duhet të themelohet në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi dhe, sipas tij, nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Ai ka thënë se nuk duhet të ketë dallime në mes të asociacioneve. Gashi është shprehur i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit në mes të nivelit lokal dhe atij qendror duke thënë se një gjë e tillë duhet të vazhdojë edhe më tutje. Ai ka bërë me dije se Ligji për Obiliqin do të fillojë të zbatohet nga janari i vitit të ardhshëm

# Koha e fundit për konsensus rreth dialogut me Serbinë

Përfaqësuesit e partive politike dhe njohësit e rrethanave politike vazhdojnë të besojnë se ende mund të arrihet një konsensus kombëtar rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se tani është koha e fundit që të arrihet një ujdi për këtë çështje. Sipas tyre, konsensusi mund të arrihet duke hequr dorë prej interesave të ngushta partiake FAQE 3






## Hoxha: Pas liberalizimit, statusi i kandidatit për anëtarësim në BE deri në 2020-n

FAQE 7

## AKTUALE

**REFERENDUMI, PJESËMARRJA DHE VOTA PRO SJELLIN NJË FAQE TË RE PËR MAQEDONINË DHE MBARË RAJONIN** F. 11

Prof. Lisen BASHKURTI



**KËRKESA E THAÇIT NDAJ GJYKATËS KUSHTETUESE PRITET ME DYSHIME** F. 5

**PËRUROHET PLLAKA PËRKUJTIMORE E DOKTOR LEC GRADICËS** F. 10

**RIVARROSEN ESHTRAT E DËSHMORËVE AHMET KRASNIQI DHE QAZIM JAKUPI** F. 6

## EKONOMI

**KOSOVA TA ADRESOJË URGJENTISHT PËRGATITJEN E KUADROVE TË FUQISË PUNËTORE** F. 8

**LEKAJ: PRIORITETI IM, KRIJIMI I SIGURISË NË KOMUNIKACION** F. 8

## KULTURË

**FJALA E LULZIM TAFËS ME RASTIN E MARRJES SË ÇMIMIT ' MIHAI EMINESCU'** F. 13




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Vuçiqi: Nuk dua të më thonë se është mirë ta njoh Kosovën

**Beograd, 21 shtator** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se është gjithmonë për vazhdimin e dialogut me Kosovën, porse është e nevojshme të dihet se cila është tema e tij. "Unë të shkoj atje dhe të më thonë se do të ishte mirë ta njoh Kosovën dhe se do të isha udhëheqës botëror nëse e bëj një gjë të tillë - nuk dua. Nuk më intereson. Nuk dua të jem udhëheqës botëror. Çka tani? Do të më zëvendësoni si disa? Unë prej këtij vendi nuk ik. As unë, as fëmijët e mi, tre i kam", u tha Vuçiqi gazetarëve në Beograd, transmeton Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë".
Ai tha se nuk mendon se është zgjidhje që Serbia të mos fitojë asgjë në dialog dhe të poshtërohet. "Unë nuk do ta pranoj një gjë të tillë. Pikë", tha Vuçiqi.
Prishtina dhe Beogradi, qysh në vitin 2011, po bisedojnë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve. Së voni, përfaqësuesit e dy vendeve kanë shpalosur idenë e ndryshimit të kufijve si zgjidhje e mundshme. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se një gjë e tillë mund ta sjellë njohjen nga Serbia.



# Anëtarësimi në NATO e bën Maqedoninë vend të sigurt

Sipas ekspertëve të sigurisë, anëtarësimi i Maqedonisë në NATO në masë të madhe do t'i përforcojë kapacitetet e organeve të sigurisë në luftën kundër terrorizmit global dhe që kthimi i një pjese të caktuar të shtetasve maqedonas nga viset e prekura nga lufta në Siri dhe vendet e tjera, paraqet kërcënim real për Maqedoninë



**Shkup, 21 shtator** - Ekspertët e sigurisë konsiderojnë se anëtarësimi i Maqedonisë në NATO në masë të madhe do t'i përforcojë kapacitetet e organeve të sigurisë në luftën kundër terrorizmit global. Sipas ekspertëve të sigurisë, kthimi i një pjese të caktuar të shtetasve të Maqedonisë nga viset e prekura nga lufta në Siri dhe vendet e tjera paraqet kërcënim real për Maqedoninë. Këto komente vijnë pasi në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për terrorizëm dhe dhunë ekstremiste, është theksuar se "Maqedonia bashkëpunon me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në përpjekjet anti-terroriste dhe është në koalicionin botëror për humbjen e ISIS-it".
Bllagoja Markoski nga Forumi Ballkanik për Siguri konsideron se me vetë faktin se mbi 180 persona nga Maqedonia kanë marrë pjesë në luftërat e huaja në Lindjen e Mesme dhe një pjesë e madhe e tyre, përkatësisht mbi 80, tanimë janë kthyer në Maqedoni, me vete bartin ideologjinë e ISIS-it. "Qëllimi i anëtarësimit të Maqedonisë në NATO është që vendin ta bëjë më të sigurt. Anëtarësimi i vendit në aleancë do ta përforcojë rrjetin e informimit mes strukturave të sigurisë së vendit dhe strukturave të NATO-s dhe në këtë aspekt mund të veprohet në masë të madhe në aspektin e parandalimit të akteve që kërcënojnë sigurinë e vendit", konsideron Markoski.
Në raportin e DASh-it thuhet se "Qeveria e Maqedonisë thekson se pjesëtarët dhe simpatizantët e IS-it janë të pranishëm në vend. MPB dhe agjencitë e zbulimit vlerësojnë se së paku 150 shtetas të Maqedonisë kanë shkuar për t'iu bashkangjitur grupeve terroriste në Siri dhe Irak. Nga ato, 30 janë vrarë, 40 edhe më tej janë të pranishëm, ndërsa 80 prej tyre janë kthyer në Maqedoni".
Ekspertët në këtë lëmë vlerësojnë se strukturat e sigurisë së vendit duhet të punojnë më tepër në detektimin e celulave prej ku rekrutohen personat që bëhen pjesë e luftërave të huaja.
Samet Shabani, hulumtues i çështjeve që lidhen me radikalizmin, vë theksin edhe në nevojën e socializimit të personave të cilët janë kthyer nga luftërat e huaja, por edhe familjes më të gjerë. "Aktualisht në Maqedoni nuk ka programe aktive për risocializim dhe riintegrim të të burgosurve (apo edhe familjarëve të tyre) për vepra penale të ndërlidhura me përfshirje në luftëra të huaja. Madje gjatë qeverisjes së kaluar të burgosurit si dhe familjarët e tyre janë ballafaquar me një sërë parregullsish në raport me institucionet publike. Sidoqoftë, Qeveria aktuale në mars të këtij viti ka miratuar Strategji për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm ku, mes të tjerash, është paraparë program për riintegrim të të burgosurve si dhe familjarëve të tyre", thotë Shabani.
Përderisa Stefan Buxhakoski, ekspert për çështje të sigurisë, për "Radion Evropa e Lirë" theksoi se Maqedonia si shtet ka rol aktiv në luftën globale kundër terrorizmit, megjithatë anëtarësimi në Aleancën veriatlantike do të kontribuojë në masë të madhe në përforcimin e kapaciteteve në aspektin preventiv sa i përket luftës kundër terrorizmit.
Edhe Buxhakoski thotë se pjesëmarrja e shtetasve të Maqedonisë në luftërat e huaja vendin e bën të ndjeshëm ndaj sulmeve terroriste dhe duhet angazhuar në mënyrë institucionale në deradikalizimin e tyre. "Maqedonia si shtet për shkak të pozitës së vet specifike në aspektin gjeostrategjik si dhe për shkak të asaj se është shtet shumetnik gjithmonë është në rrezik të shkaktimit të akteve terroriste dhe për këtë arsye përcaktimi për t'u bërë pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian do të thotë më shumë siguri në kuadër të një sistemi global", vlerëson Buxhakoski.
Në raportin e DASh-it është vënë theksi në angazhimin e Qeverisë së Maqedonisë, së fundmi në "forcimin e legjislacionit dhe forcimin e kapaciteteve për luftën kundër terrorizmit dhe financimin e tyre, si dhe për forcimin e sigurisë së internetit dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë".

## Lavrovi: Të zbatohen marrëveshjet Kosovë - Serbi

**Sarajevë, 21 shtator** - Ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, ka thënë se Rusia e përshëndet dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit si dhe ka bërë thirrje që marrëveshjet që arrihen nga ky dialog të zbatohen. "Është e nevojshme të respektohen parimet e Rezolutës 1244. Ne e përshëndesim dialogun e drejtpërdrejtë ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, por më e rëndësishme është që ajo që arrihet përmes dialogut të realizohet vërtet", ka thënë Lavrov në një vizitë që realizoi të premten në Bosnjë e Hercegovinë. Ai ka theksuar të gjithë lojtarët e jashtëm në Ballkan nuk duhet të krijojnë ndonjë situatë konflikti dhe se asnjëri nuk duhet të mendojë se vetëm ai ka të drejtë të merret me situatën në Ballkan dhe të tjerët jo. Pas takimeve me autoritetet e këtij vendi, Lavrovi ka thënë se Rusia mbështet integritetin dhe sovranitetin e Bosnjë e Hercegovinës.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Koha e fundit për konsensus rreth dialogut me Serbinë

Përfaqësuesit e partive politike dhe njohësit e rrethanave politike vazhdojnë të besojnë se ende mund të arrihet një konsensus kombëtar rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se tani është koha e fundit të arrihet një ujdi për këtë çështje. Sipas tyre, konsensusi mund të arrihet duke hequr dorë prej interesave të ngushta partiake



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Përfaqësuesit e partive politike dhe njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se është koha e fundit që pozita dhe opozita të gjejnë një konsensus kombëtar rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. Ata kanë shprehur optimizëm se një gjë e tillë mund të arrihet nëse subjektet politike heqin dorë nga interesat e ngushta partiake.

Zëvendëskryeministri i Kosovës dhe zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka vlerësuar se janë duke u bërë përpjekje në këtë drejtim. "Po punojmë që të ketë mirëkuptim dhe bashkëpunim politik drejt një konsensusi. Kemi pasur situata absurde edhe para një kohe kur skena politike ishte e përçarë për, gjoja, një marrëveshje jo të drejtë sa i takon demarkacionit me Malin e Zi. Ndërsa fakti se tash nuk merremi vesh as për formën e përfaqësimit tonë në dialog, as për përmbajtjen e dialogut, flet se është koha e fundit dhe janë kambanat e fundit të alarmit që të gjithë ne në elitën politike do të duhej të ulemi dhe të merremi vesh se si të shtyhet dialogu përpara", ka thënë Hoxhaj. Sipas tij, zvarritja e konsensusit kombëtar shkon në dëm të Kosovës. "Nëse dikush mendon se mund ta bllokojmë Serbinë duke i zvarritur punët tona të brendshme, duke mos krijuar një mirëkuptim dhe konsensus të brendshëm dhe që bashkësia ndërkombëtare ka kohë të pafundme që ta presë Kosovën, e kanë shumë gabim. Jam kundër asaj që ta ruajmë statuskohën në Kosovë, por në përputhje me përgjegjësitë politike duhet ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës dhe ajo mund të ndodhë nëse vendi anëtarësohet në OKB. Historia e dhjetë vjetëve të fundit ka treguar se vendi nuk mund të anëtarësohet në OKB pa mbështetjen edhe të Rusisë e cila ndjek politikë të njëjtë me Serbinë", ka thënë Hoxhaj.

Edhe njohësi i proceseve politike në vend, Mazllum Baraliu, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se është koha e fundit që subjektet politike të heqin dorë nga interesat e ngushta për ato kombëtare. "Nuk duhet të shkohet në bisedime pa një platformë dhe pa përgatitje, pa marrë parasysh ingerencat kushtetuese. Është koha e fundit e vetëdijesimit të kësaj klase politike që në Kuvend të merren vesh për këto çështje. Po ashtu, Kosova nuk ka nevojë të ngutet për dialog me Serbinë. Do të duhej të ketë durim, të bëhet punë dhe të arrihet një marrëveshje konsensuale para se dikush të shkojë atje për interesa të Serbisë, apo qarqeve të caktuara të Bashkimit Evropian, i cili është në një situatë krize. Ne duhet të përgatitemi dhe të jemi të unifikuar si klasë politike në këtë proces. Përndryshe, mund të bëhen gabime edhe më të mëdha sesa këto që janë bërë gjatë këtyre viteve", është shprehur ai duke i fajësuar për moskonsensus pozitën dhe opozitë.

Ai ka bërë me dije se nëse subjektet politike nuk arrijnë të merren vesh për dialogun me Serbinë, alternativë e vetme mbesin zgjedhjet e reja. "Nëse nuk do të gjendet një pajtim mes subjekteve politike për dialog dhe për çështje të tjera kombëtare, patjetër se duhet të shikohet mundësia e mocionit të mosbesimit për ta rrëzuar Qeverinë. Nuk ka zgjidhje tjetër pos hapjes së rrugës për zgjedhje të reja, ku do të bëhet verifikimi edhe një herë i cilido subjekt politik. Zgjedhjet e reja do ta sjellin krijimin e një legjitimiteti dhe legaliteti të ri, pra do të kemi një strukturë të re qeverisëse e cila, ndoshta, do ta menaxhonte më mirë ardhmërinë e këtij shteti dhe konsolidimin e tij. Kështu si po ecet, nuk ka kuptim. Kjo klasë politike duhet të kuptojë se kështu më nuk bën të vazhdohet", ka thënë Baraliu.

Ndërsa nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka ftuar subjektet politike për një konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se konsensusi politik dhe shoqëror për dialogun është i domosdoshëm. "Konsensusi politik e shoqëror për dialogun është i domosdoshëm. Para se të flasim për mundësinë e arritjes së tij duhet ta themi qartë dhe troç: nuk mund të ketë dialog pa konsensus. Shteti ynë dhe shoqëria jonë e kanë shumë të rëndësishme që të debatojnë seriozisht për synimet tona politike, socio-ekonomike dhe pozicionin tonë rajonal. Ky lloj diskutimi është rruga drejt konsensusit që do ta forconte shumë pozicionin tonë në dialog. Para së gjithash, ne duhet të kemi projekt dhe vendosmëri për shtetndërtim në Republikën e Kosovës", ka thënë Ymeri.

Kuvendi i Kosovës ka ngecur në një situatë ku nuk po mund të marrë ndonjë vendim në lidhje me fazën finale të dialogut me Serbinë. Pozita nuk po mund ta bëjë kuorumin për votimin e ekipit negociator për bisedime të cilin e ka propozuar Qeveria, kurse opozita nuk po mund të krijojë kuorum për miratimin e një rezolute për këtë fazë të dialogut.

# Lëvizja Vetëvendosje sot mban protestë në Prishtinë

PRISHTINË, 21 SHTATOR (ER) - Sot (e shtunë) në orën 14:00, në Prishtinë, Lëvizja Vetëvendosje do të organizojë protestë për shkak të gjendjes politike në vend dhe për shkak të veprimeve të fundit të presidentit Hashim Thaçi në raport me dialogun me Serbinë.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka ftuar të gjithë qytetarët pa dallim moshe dhe gjinie që t'i bashkohen kësaj proteste. Gjithashtu, nëpërmjet një videomesazhi Kurti ka ftuar bashkatdhetarët t'i bashkohen protestës së kësaj lëvizje. Ai ka thënë se porsa kanë paralajmëruar protestën e 29 shtatorit kanë marrë mesazhe për t'u bashkuar në protestë.

Kurti ka folur të drejtat e mërgimtarëve të cilat u mungojnë si në vendet ku jetojnë, po ashtu edhe në Kosovë, duke premtuar se ato do t'i zgjidhë Lëvizja Vetëvendosje. Sipas tij, pazaret vetjake të Hashim Thaçit me Vuçiqin po sjellin probleme të mëdha. Kurti ka thënë se këto pazare përfshijnë edhe një gabim historik që duhet parandaluar siç është zëvendësimi i Gjermanisë me Rusinë në politikën tonë të jashtme.



Flet për "Epokën e re", Xhafer Gashi

# Asociacioni i Komunave Serbe të j



**Zëvendëskryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), njëherësh kryetar i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, e ka quajtur të panevojshëm themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Megjithatë, ai ka thënë se edhe nëse ky asociacion bëhet duhet t'i ketë kompetencat e njëjta me Asociacionin e Komunave të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka theksuar se asociacioni duhet të themelohet në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi dhe, sipas tij, nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Ai ka thënë se nuk duhet të ketë dallime në mes të asociacioneve. Gashi është shprehur i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit në mes të nivelit lokal dhe atij qendror duke thënë se një gjë e tillë duhet të vazhdojë edhe më tutje. Ai ka bërë me dije se Ligji për Obiliqin do të fillojë të zbatohet nga janari i vitit të ardhshëm**

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Zëvendëskryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), njëherësh kryetar i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka thënë të premten se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se Asociacioni i Komunave Serbe duhet të jetë i njëjtë me AKK-në. "Asociacione mund të themelohen sa të duan në Republikën e Kosovës, por vetëm duhet të bazohen në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi. Ndonëse kjo është çështje e nivelit qendror, megjithatë nuk besoj se do të ndodhë një gjë e tillë, pra që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të ketë kompetenca dhe të dallojë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Nuk besoj se do të ketë dallime në mes të asociacioneve", ka deklaruar ai, duke shtuar se themelimi i këtij Asociacioni është i panevojshëm. "Faktikisht nuk është i nevojshëm, por Kushtetuta lejon që një grup i komunave të kenë një asociacion. Edhe në Shqipëri janë dy asociacione të komunave, mirëpo kompetencat i kanë të njëjta dhe të barabarta", ka theksuar Gashi.

Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të ketë bashkëpunim në mes të dy asociacioneve. Gashi është shprehur i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit në mes të nivelit lokal dhe atij qendror duke thënë se një gjë e tillë duhet të vazhdojë edhe më tutje dhe të gjitha projektet e arsyeshme duhet të implementohen. Kurse sa i përket moszbatimit të Ligjit për Obiliqin, ai ka thënë se vonesat në këtë drejtim janë shkaktuar për shkak të taksës për eksploatimin e thëngjillit. Gashi ka bërë me dije se tashmë kjo çështje është paraparë në kornizën buxhetore dhe, sipas tij, nga janari i vitit të ardhshëm ky ligj do të fillojë të implementohet. "Nuk presim pengesa. Sepse çështja e tantiemës tanimë është ndarë me kornizën buxhetore dhe kjo nënkupton se kemi filluar planifikimin e buxhetit për vitin 2019 duke përfshirë edhe hyrjet që do të jenë nga tantiema e eksploatimit të thëngjillit. Prandaj nga janari presim zbatimin e Ligjit për Obiliqin sepse kemi marrë konfirmimin nga Ministria e Financave që ligji do të buxhetohet në vlerën që e përmenda", është shprehur ai.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, edhe më tutje nuk ka implementim të Ligjit për Obiliqin. Pse kjo vonesë?*

**Gashi:** Tashmë kemi marrë

# etë i njëjtë me asociacionin tonë



konfirmimin se Ligji për Obiliqin do të buxhetohet nga janari i vitit të ardhshëm. Tantiema (taksa për eksploatimin e thëngjillit) fillon të paguhet nga janari i vitit 2019 dhe Obiliqi do t'i përfitojë edhe 4 milionë e 975 mijë euro dhe kjo pritet të ndryshojë varësisht nga eksploatimi i thëngjillit. Përveç Ministrisë së Financave, shpresojmë se edhe ministritë e tjera ta fillojnë realizimin e përgjegjësive që ua jep Ligji për Obiliqin.

**"Epoka e re":** *Që do të thotë se më nuk do të ketë pengesa, por që nga janari i vitit të ardhshëm do të nisë zbatimi i Ligjit për Obiliqin?*

**Gashi:** Nuk presim pengesa. Sepse çështja e tantiemës tanimë është ndarë me kornizën buxhetore dhe kjo nënkupton se kemi filluar planifikimin e buxhetit për vitin 2019 duke përfshirë edhe hyrjet që do të jenë nga tantiema e eksploatimit të thëngjillit. Prandaj, nga janari presim zbatimin e Ligjit për Obiliqin sepse kemi marrë konfirmimin nga Ministria e Financave që ligji do të buxhetohet në vlerën që e përmenda.

**"Epoka e re":** *Në mungesë të zbatimit të këtij ligji, cilat janë humbjet që po i shkaktohen komunës dhe qytetarëve të saj?*

**Gashi:** Realisht në mungesë të zbatimit të Ligjit për Obiliqin nuk mund të zhvillohen projektet e parapara. Megjithatë, si duket, pritjes i ka ardhur fundi dhe nga janari i vitit të ardhshëm do ta fillojmë zbatimin e ligjit.

**"Epoka e re":** *Duke qenë në pozitën e zëvendëskryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), keni arritur t'i evidentoni dhe trajtoni problemet me të cilat ballafaqohen komunat në përgjithësi?*

**Gashi:** Komunat në Kosovë ballafaqohen me sfida të shumta. Megjithatë, po bëhet e pamundur që shqetësimet e komunave të bartën nëpër ministri përkatëse.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, ka bashkëpunim të duhur ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror?*

**Gashi:** Vendimet që janë marrë deri më tani nga Qeveria Haradinaj tregojnë për nivelin e bashkëpunimit në mes të nivelit qendror dhe komunave. Të gjitha projektet që janë të arsyeshme duhet të implementohen nga ministritë e linjave përkatëse. Është fat i mirë që tani kemi koordinatorin Besnik Tahiri si dhe kemi pasur rastin që disa herë të takohemi me kryeministrin Haradinaj dhe me kryetarët e komunave bashkërisht në mënyrë që të trajtojmë tema të cilat janë të ndjeshme dhe të domosdoshme për komunat. Kjo ka arritur një rezultat jashtëzakonisht të mirë, nuk po e them këtë se i përkas Aleancës, por sepse me të vërtetë kemi mundësi t'i shprehim shqetësimet e komunave para kryeministrit dhe ta marrim mbështetjen e duhur.

**"Epoka e re":** *Cilat mbesin shqetësimet kryesore në këtë drejtim?*

**Gashi:** Komunat janë fronti i parë që përballen me shqetësimet e qytetarëve varësisht prej komunave. Pothuajse në tërësi problematikat janë të njëjta dhe tani për tani shqetësimi më i madh është mirëmbajtja e investimeve kapitale. Pra, investimet kapitale janë duke u zhvilluar nëpër të gjitha komunat, mirëpo problem mbetet planifikimi i mirëmbajtjes së tyre duke i llogaritur edhe mallrat e shërbimet që duhet patjetër të diskutohet në këtë drejtim në nivelin qendror, konkretisht në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që të bëhet një zgjidhje, sepse shumë projekte në shumë komuna janë realizuar, por ato kërkojnë edhe mirëmbajtje.

**"Epoka e re":** *Si e shihni themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe?*

**Gashi:** Asociacione mund të themelohen sa të duan me Republikën e Kosovës, por vetëm duhet të bazohen në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi.

**"Epoka e re":** *Pra, Asociacioni nuk duhet të ketë assesi kompetenca ekzekutive?*

**Gashi:** Absolutisht jo. Duhet të jetë i barabartë me Asociacionin tonë dhe asociacionet e tjera në rajon.

**"Epoka e re":** *Po nëse do të ketë kompetenca?*

**Gashi:** Ndonëse kjo është çështje e nivelit qendror, megjithatë nuk besoj se do të ndodhë një gjë e tillë, pra që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, të ketë kompetenca dhe të dallojë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Nuk besoj se do të ketë dallime në mes të asociacioneve.

**"Epoka e re":** *Është i nevojshëm krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe?*

**Gashi:** Faktikisht nuk është i nevojshëm, por Kushtetuta lejon që një grup i komunave të kenë një asociacion. Edhe në Shqipëri janë dy asociacione të komunave, mirëpo kompetencat i kanë të njëjta dhe të barabarta.

**"Epoka e re":** *Në rast se do të themelohet ky asociacion a do të bashkëpunoni me të?*

**Gashi:** Unë besoj se do të ketë bashkëpunim. Pse mos të ketë bashkëpunim? Mirëpo kompetencat duhet t'i kenë të njëjta edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, edhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.

# Delawie: Kosova e Serbia të arrijnë marrëveshje të qëndrueshme

Prishtinë, 21 shtator - Ambasadori amerikan në largim, Greg Delawie, ka thënë se nuk pajtohet se dialogu është zhdukur nga fokusi i publikut dhe se ka shumë diskutime rreth dialogut. "Nuk është diskutim krejtësisht i frytshëm, por sigurisht se ka shumë dyshime në publik për këtë. Unë ende mendoj se është shumë e rëndësishme për Kosovën dhe Serbinë të gjejnë një lloj marrëveshje të paqes, për ta arritur normalizimin për të cilin ne të gjithë kemi folur. Mendoj se bisedat që kanë ndodhur midis presidentit Thaçi dhe presidentit Vuçiq janë shumë të rëndësishme", ka thënë Delawie në intervistën për "Kossev". Sipas tij, në anën e Kosovës duhet të ketë legjitimitet shtesë demokratik për këto negociata. "Do të doja ta shihja Kuvendin e Kosovës duke votuar për ndonjë lloj strategjie apo qëllimesh, apo diçka të tillë, për të përcaktuar se cilat janë qëllimet e Kosovës në këtë diskutim. Kështu që unë mendoj se kjo është gjëja e madhe që mungon tani. Nëse ka ndonjë lloj marrëveshjeje midis presidentit Vuçiq dhe presidentit Thaçi dhe ajo kthehet në Kuvendin e Kosovës dhe është krejtësisht lajm i ri për ta, kjo nuk do të jetë e mirë, sepse një marrëveshje ndërkombëtare si kjo do të kërkojë tetëdhjetë vota. Siç e di nga përvoja ime me Marrëveshjen e Demarkacionit Kufitar me Malin e Zi, marrja e tetëdhjetë votave për çfarëdo këtu nuk është diçka e parëndësishme. Kështu që mendoj se duhet të përfshihet më shumë procesi politik në këtë diskutim", ka thënë ai, transmeton "RTKlive".



## Haradinaj: Është koha ta ndryshojmë ambientin

PRISHTINË, 21 SHTATOR (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka falënderuar të gjithë vullnetarët dhe ata që po angazhohen në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", duke thënë se kjo gjendje jo e mirë është lënë gjatë, por tani është koha e fundit që vërtet të mos lejohet më. Ai ka thënë se aksioni i nisur për pastrimin e Kosovës e ka një peshë shumë të madhe, duke besuar se është e kuptueshme tashmë se sa rëndësi ka kjo iniciativë. "Falënderoj të gjithë vullnetarët, komunën, rininë e të gjitha partive dhe kompanitë. Është e pakuptimtë dhe këtë gjendje nuk do ta lejojmë më. Në të ardhmen do të ketë edhe masa ndëshkuese", është shprehur kryeministri Haradinaj.
Koordinatori i "Let's Do It Kosova", Luan Hasanaj, ka ftuar të gjithë qytetarët që të vazhdojnë ta ruajnë ambientin dhe të ndihmojnë në ruajtjen e ambientit. "E kemi obligim të kujdesemi për hapësirat publike dhe u bëj apel të gjithëve që të bashkohen në aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën'. Kështu do të vazhdojmë deri më 15 dhjetor kur do ta kemi Kosovën e pastër dhe do të kujdesimi që këto hapësira të mirëmbahen dhe të ruhen", ka thënë Hasanaj.
Aksionit "Ta pastrojmë Kosovën" i janë bashkuar edhe tifozët "Dardanët" dhe vullnetarë të tjerë, si dhe kompani të ndryshme të pastrimit.



# Rivarrosen eshtrat e dëshmorëve Ahmet Krasniqi dhe Qazim Jakupi

Në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë, me nderime të larta ushtarake, të premten është bërë rivarrimi i eshtrave të heroit Ahmet Krasniqi dhe të dëshmorit Qazim Jakupi. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, bashkëluftëtarë dhe familjarë të dy dëshmorëve



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Me nderime të larta shtetërore në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë të premten janë rivarrosur eshtrat e ish-ministrit të Mbrojtjes, Ahmet Krasniqit dhe të Qazim Jakupit, babait të Leonora Jakupit. Pas 20 vjetësh eshtrat e kolonelit Ahmet Krasniqi janë rivarrosur në vendlindjen e tij në Kosovë. Në rivarrimin e tyre kanë marrë pjesë kryeministri Ramush Haradinaj, ministra, kryetarë komunash, bashkëluftëtarë të tij dhe qytetarë të shumtë. "Shqiptarët jeta i ka përpjekur, i ka ndarë e i ka kthyer në shtegtarë. Disa prej tyre në kohë të caktuara rrugët e jetës i kanë nxjerrë në skaje të largëta, por çdo shqiptar në jetën e vet, që nga lindja e deri në amshim, një gjë e ka të përbashkët me çdo shqiptar tjetër, atdheun, tokën e të parëve të tij. Është nder i posaçëm sot për të gjithë ne që ta vëmë një drejtësi në vend, që ta kthejmë në atdheun e tij, heroin tonë, kolonelin, ministrin e kohës së luftës, Ahmet Krasniqin dhe dëshmorin Qazim Jakupi", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në akademinë përkujtimore për heroin e kombit, kolonel Ahmet Krasniqi dhe dëshmorin Qazim Jakupi.
Para të pranishmëve të shumtë, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, bashkëluftëtarë e familjarëve të heronjve, kryeministri Haradinaj ka thënë se edhe pse nuk e ka njohur si bashkëluftëtar kolonel Ahmet Krasniqin, vetë fakti se është i shtëpisë së Aziz Zhilivodës flet shumë. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka thënë se rruga deri në liri ka qenë shumë e gjatë, e vështirë dhe me shumë paqartësi dhe vuajtje, por secili që ka bërë hapa në rrugën drejt lirisë e ndien hapin e tjetrit, jo vetëm të luftës, pushkës, por edhe të penës, edhe të çdo veprimtarie që ka ndihmuar ardhjen deri te liria.
Në akademinë përkujtimore folën edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ndërsa në emër të bashkëveprimtarëve dhe bashkëluftëtarëve të heronjve para të pranishmëve foli ministri i FSK-së, Rrustem Berisha.
Të pranishmit i falënderuan Behxhet Krasniqi, vëllai i heroit Ahmet Krasniqi dhe Leonora Jakupi, e bija e dëshmorit Qazim Jakupi.
Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se lufta e UÇK-së bëri që të gjithë atdhetarët, kudo që ishin, të bashkoheshin pa dallime ideologjike dhe partiake në aspiratën tonë shekullore për liri dhe pavarësi. "Nga sot të dy heronjtë do të pushojnë të qetë në tokën e Kosovës së lirë", ka thënë Thaçi.
Të gjitha ceremonitë për rivarrimin e heroit kolonel Ahmet Krasniqi dhe dëshmorit Qazim Jakupi u organizuan nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Ahmet Krasniqi është vrarë në vitin 1998 në Tiranë, ku për 20 vjet ishte i varrosur atje.

## Ambasadori Braathu premton përkrahje për AGK-në

PRISHTINË, 21 SHTATOR (ER) - Kryetarja e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), Gentiana Begolli-Pustina, është pritur të premten në një takim pune nga udhëheqësi i misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Jan Braathu.
Kryetarja Begolli-Pustina e ka njoftuar ambasadorin Braathu për zhvillimet e fundit në AGK dhe për strukturën e saj të re e dalë nga Kuvendi i fundit zgjedhor. Më tej, kryetarja Begolli-Pustina e ka informuar ambasadorin Braathu me aktivitetet dhe projektet aktuale të AGK-së dhe për planet për të ardhmen.
Në takim u kërkua shtimi i bashkëpunimit ndërmjet AGK-së dhe misionit të OSBE-së dhe realizimi i aktiviteteve të përbashkëta që lidhen me sigurinë e gazetarëve, gazetarinë hulumtuese dhe avokimin e lirisë së shprehjes.
Ndërsa ambasadori Braathu ka përgëzuar edhe një herë kryetaren Begolli-Pustina për detyrën e re dhe ka shprehur gatishmërinë dhe vullnetin që misioni i OSBE-së ta përkrahë fuqishëm punën dhe angazhimet e AGK-së.
Ambasadori Braathu e çmoi lart rolin e organizatave profesionale dhe të pavarura për zhvillimin e demokracisë dhe shpalosi disa prej mundësive të bashkëpunimit dhe përkrahjes për AGK-në.



# Kërkesa e Thaçit ndaj Gjykatës Kushtetuese pritet me dyshime

Nisma e fundit e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, për interpretimin e nenit 18 të Kushtetutës së Kosovës, që tregon për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, për partitë politike opozitare dhe analistët politikë është e papranueshme

**Prishtinë, 21 shtator** - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese nëse marrëveshja në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian për mandatin e ri të EULEX-it do duhej të miratohej nga 2/3 e Kuvendit apo një gjë të tillë mund ta bëjë presidenti përmes shkëmbimit të letrave. Zyra për Media në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se kërkesa e Thaçit "tashmë është regjistruar dhe proceduar nga Gjykata". E kontaktuar nga "REL", Zyra e Presidentit nuk ka dashur ta komentojë iniciativën e Thaçit. Për partitë opozitare këto veprime të presidentit janë një tendencë tjetër që procesi i dialogut dhe marrëveshjet e mundshme me Serbinë t'i bëjë vetë Thaçi pa kaluar në Kuvend. Sipas tyre, rasti i EULEX-it mund të shërbejë edhe për marrëveshje të tjera si ajo me Serbinë.

Deputeti Frashër Krasniqi nga PSD-ja ka pohuar se kjo është një tendencë e re e Thaçit për të marrë një rol që nuk i takon dhe për ta fuqizuar rolin e tij politik. Ai thotë se presidenti me veprimet e tij po e dërgon vendin drejt një lloj autoritarizmi presidencial. "Mendojmë se është e papranueshme kjo tendencë e pakompromis e Thaçit që t'i ikë Kuvendit dhe ta largojë vendimmarrjen nga Kuvendi. Kushtetuta e Kosovës e përcakton shumë qartë që marrëveshjet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me integritetin territorial me çështje të rëndësishme për Republikën e Kosovës duhet të miratohen në Kuvend me dy të tretat [2/3]", ka deklaruar Krasniqi. Ai ka shtuar se presidenti Thaçi e di se nuk e ka mbështetjen e opozitës dhe as të deputetëve të tjerë jashtë opozitës dhe po tenton të nënshkruajë një marrëveshje pa ratifikimin e saj nga Kuvendi.



Kosovës (04.06.2018) dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë (08.06.2018):

1.1. a duhet të ratifikohen, në cilësinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve (në pajtim me Nenin 18.1. të Kushtetutës) apo

1.2. a duhet të konsiderohen të ratifikuara pas nënshkrimit nga Presidenti (në pajtim me Nenin 18.2. të Kushtetutës), për shkak të ndërrimit të rolit dhe mandatit ekzekutiv të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, pasi që tani e tutje do të ketë rol kryesisht këshillëdhënës dhe monitorues.

Zyra ime do të qëndrojë në dispozicionin tuaj për çfarëdo informate shtesë lidhur me këtë kërkesë.

Me respekt!

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Official publication

Ahmet Isufi, shef i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, parti kjo në pushtet, ka thënë për "REL" se kërkesa e presidentit drejtuar Gjykatës Kushtetuese është normale dhe, siç ka thënë ai, askush nuk mund të përzihet në punët e asaj gjykate. Ai ka theksuar se respektimi i Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi është detyrë e çdo institucioni. "Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë të sanksionuara të gjitha obligimet dhe të drejtat të cilat normalisht se duhen respektuar. Prandaj marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe derisa të ekzistojë kjo Kushtetutë ato janë obliguese", ka deklaruar Isufi.

Analisti politik Imer Mushkolaj, duke folur për "REL", ka deklaruar se presidenti Thaçi me çdo kusht po mundohet që marrëveshjen për ndryshimin e kufirit Kosovë - Serbi të mund ta legjitimojë për qytetarët e Kosovës. Ky veprim i presidentit, sipas Mushkolajt, po bëhet pasi ai nuk ka përkrahjen për të negociuar në dialogun politik Kosovë - Serbi. "Presidenti nuk është dashur të kërkojë interpretim për shkak se edhe përvojat e kaluara kanë treguar se marrëveshjet ndërkombëtare janë miratuar me 2/3 në Kuvendin e Kosovës, po është edhe një përpjekje e tij që t'i anashkalojë të gjitha institucionet e tjera dhe çfarëdo marrëveshje që arrin dhe që mban vulën e tij të prezantohet si e mirëqenë për Kosovën dhe qytetarët e saj", ka deklaruar Mushkolaj.

Pasi kërkesa e presidentit Thaçi është proceduar në Gjykatën Kushtetuese, kryetarja Arta Rama ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i japin mendimet e tyre lidhur me letrën dhe kërkesën që presidenti ka dërguar në gjykatë.

Ndryshe, në nenin 18 të Kushtetutës së Kosovës thuhet se Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje, si: territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake, të drejtat dhe liritë themelore, anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare e të tjera.

# Pas liberalizimit, statusi i kandidatit për anëtarësim në BE deri në 2020-n

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, thotë se pas procesit të liberalizimit të vizave synimi strategjik i Qeverisë së Kosovës është përmbushja e kritereve për ta marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE deri në vitin 2020

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 21 shtator** - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, si paneliste ka mbajtur fjalë rasti për temën "Rruga e Kosovës në Bashkimin Evropian", nën organizim të Akademisë Liberale Regjionale Politike dhe me përkrahjen e Fondacionit Ndërkombëtar të Qendrës, ku vuri në pah rëndësinë e procesit të integrimit evropian dhe përkushtimin e Qeverisë në këtë proces. "Procesi i integrimit evropian është karakterizuar me një dinamikë progresive në vitet e fundit, por ende mbetet shumë për t'u bërë. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ka hyrë në fuqi duke krijuar në një anë obligimet kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së, në anën tjetër duke përfaqësuar themelet e anëtarësimit sonë në BE", ka thënë ministrja Hoxha, duke cekur se hapi i radhës më i rëndësishëm është liberalizimi i vizave.

Ajo ka theksuar se raporti tejet pozitiv i Komisionit Evropian ka konfirmuar punën e institucioneve të Kosovës duke dëshmuar se ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara, gjithsejtë 95 për liberalizimin e vizave dhe pret që BE-ja t'i mbajë premtimet dhe kryejë detyrat e veta që qytetarët e Republikës së Kosovës ta kenë mundësinë të udhëtojnë lirshëm në vendet e Bashkimit Evropian. "Kosova tani më është pjesë e programeve të BE-së në nivelin e barabartë me të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, liberalizimit të vizave, tani synimi strategjik i Qeverisë është përmbushja e kritereve për ta marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE deri në vitin 2020", ka thënë ministrja Hoxha, duke shtuar se integrimi evropian nuk është alternativë, por është rruga jonë e vetme.




Duke folur për strategjinë për zgjerim të BE-së, ministrja ka bërë të qartë se Kosova do të hyjë në BE sikurse vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, po jo në gjendjen që janë tani. "Kjo do të thotë shumë për Kosovën dhe mendoj se duhet parë si pozitive dhe duhet shfrytëzuar maksimalisht. Zbatimi i MSA-së është prioriteti ynë më i rëndësishëm. Zbatimi i MSA-së tani kërkon përafrimin e legjislacionit me standardet e BE-së dhe zbatimin e plotë të legjislacionit në praktikë. Kjo do të kërkojë vullnet politik, kapacitete burokratike dhe financim të qëndrueshëm", ka deklaruar ministrja Hoxha, duke theksuar se reformat në çdo fushë, në çdo sektor, duhet të jenë në funksion të zbatimit të MSA-së. "Kjo tani për tani është rruga jonë drejt avancimit në procesin e integrimit", ka thënë ajo.

Puna e institucioneve në këto fusha, vuri në dukje ministrja Hoxha, duhet të jetë konkrete dhe t'i përfshijë të gjitha hallkat e zinxhirit institucional dhe krijimin e një konsensusi nacional për reformat dhe proceset që janë pjesë e rrugës sonë drejt integrimit, e sidomos masave që janë pjesë e PKZMSA-së. "Zbatimi i MSA-së nuk është agjendë partiake, por agjendë shtetërore. Nuk është diçka për të cilën duhet të angazhohet vetëm Qeveria, por duhet të angazhohen të gjitha institucionet. Sigurisht duhet përkrahja edhe e opozitës, sidomos kur kemi të bëjmë me masat legjislative. Rruga jonë drejt integrimit nuk ka alternativë. Detyrat janë të qarta dhe na mbetet që të gjithë të angazhohemi më shumë dhe ta avancojmë këtë proces", ka thënë ministrja Hoxha.

# Lekaj: Prioriteti im, krijimi i sigurisë në komunikacion

Me rastin e Ditës Evropiane "Pa viktima në rrugë", që në shtetet evropiane shënohet çdo vit, ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se që nga marrja e mandatit të tij ministër i Infrastrukturës, prioritet ka krijimin e sigurisë në komunikacion. "Kjo siguri arrihet me ndërtimin e rrugëve me standarde të larta, por ne nuk do të mjaftohemi me kaq", ka thënë Lekaj

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 21 shtator** - Të premten është shënuar Dita Evropiane "Pa viktima në rrugë" që në shtetet evropiane shënohet çdo vit, ndërsa në Kosovë për herë të dytë. Me rastin e shënimit të kësaj dite u organizua një tryezë e ashtuquajtur "Dita evropiane pa viktima në rrugë". Në këtë tryezë i pranishëm ishte edhe ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj.

Lidhur me atë se çfarë është duke u punuar për rritjen e sigurisë në komunikacion nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës, ministri Lekaj ka thënë se lajmet për aksidentet e shkaktuara në trafik na shqetësojnë të gjithëve. "Që nga marrja e mandatit të ministrit të Infrastrukturës prioriteti im ka qenë krijimi i sigurisë në komunikacion. Kjo siguri arrihet me ndërtimin e rrugëve me standarde të larta, por ne nuk do të mjaftohemi me kaq. E kam krijuar edhe Task-Forcën për siguri në komunikacionin me ekspertë të Ministrisë dhe ekspertë të jashtëm të fushave përkatëse. Kjo Task-Forcë është duke punuar çdo ditë në terren për t'i evidentuar pikat e zeza ku po shkaktohen aksidentet", ka thënë Lekaj.

Ai ka shtuar se numri i aksidenteve për periudhën janar-gusht të këtij viti ka rënë për rreth 13 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Përqindja e aksidenteve me fatalitet është zvogëluar për 17 për qind. Thirrja ime është: 'Të gjitha rrugët pa aksidente'", ka thënë Lekaj.

Në këtë tryezë për rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor folën edhe Nora Hasani, drejtoreshë e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, drejtori i Kolegjit "Tempulli" si dhe pjesëmarrës të tjerë ekspertë të komunikacionit. U fol edhe për përgatitjen e planeve dhe veprimeve për edukimin e gjeneratave të reja për ta menaxhuar trafikun si dhe për sigurinë në rrugë dhe të gjitha aktivitetet e tjera që kanë të bëjnë me këtë siguri.

Gjatë kësaj tryeze ministri Lekaj iu përgjigj pyetjeve të cilat kishin të bënin me përmirësimin e infrastrukturës rrugore si dhe sigurinë në komunikacion. Pjesëmarrës në këtë tryeze ishin edhe pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), Policisë së Kosovës, zjarrfikësve, bashkëpunëtorë të Hekurudhave të Kosovës, të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, të AMRKS-së dhe ekspertë të ndryshëm dhe përfaqësues të institucioneve të tjera.




## FKGK-ja nënshkruan marrëveshje me Raiffeisen Leasing Kosovë

**Prishtinë, 21 shtator (ER)** - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka nënshkruar marrëveshjen e garancisë me Raiffeisen Leasing në Kosovë (RLKO).

Marrëveshja do t'i mundësojë institucionit përkatës të përfitojë më shumë siguri kolaterali për lizingjet e lëshuara për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) të regjistruara në Kosovë, duke ofruar kështu qasje më të lehtë në financa për kompanitë e Kosovës.

Marrëveshja synon ta zgjerojë lizingdhënien për bizneset e Kosovës, të kontribuojë për krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike, si dhe për rritjen e mundësive për sektorë ekonomikë e kategori që janë shërbyer më pak, si gratë, pakicat, bujqit, ndërmarrësit dhe rinia.

RLKO është Institucioni Financiar jo Bankar (IFJB) i parë i cili ka nënshkruar marrëveshjen e garancisë me FKGK-në. Ne besojmë se marrëveshja me RLKO-në do ta rrisë kontributin e këtij institucioni drejt zhvillimit të portofolit të garancisë dhe arritjes së qëllimeve të marrëveshjes.

Shuma totale e kredive të miratuara nga bankat të cilat janë vënë nën mbulimin e garancisë ka arritur tashmë rreth 62 milionë euro të shpërndara në 1 600 kredi.





# Kosova ta adresojë me urgjencë përgatitjen e kuadrove të fuqisë punëtore

Presidenti i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahimi, ka theksuar se, pavarësisht prej shifrave shqetësuese të papunësisë në vend, ndërmarrjet në Kosovë ballafaqohen me sfida jashtëzakonisht të mëdha për gjetjen e kuadrove të kualifikuara

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Përgatitja e kuadrove të kualifikuara të fuqisë punëtore që reflekton nevojat e sektorit privat përbën një ndër sfidat kryesore të Kosovës në aspekt të zhvillimit ekonomik. Kjo temë si dhe ndikimi që përfundimi i procesit të liberalizimit të vizave pritet të ketë në tregun e punës në Kosovë u trajtua në tryezën e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë "Disponueshmëria e fuqisë punëtore në Kosovë".

President i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahimi, ka theksuar se, pavarësisht prej shifrave shqetësuese të papunësisë në vend, ndërmarrjet në Kosovë ballafaqohen me sfida jashtëzakonisht të mëdha për gjetjen e kuadrove të kualifikuara. Sipas tij, këto vështirësi përkthehen në mundësi të humbura për Kosovën për zhvillimin e sektorit privat dhe rrjedhimisht zhvillimin ekonomik të vendit. Ibrahimi ka pohuar se krahas nevojës që t'i kushtohet një rëndësi më e madhe shkollimit profesional në vend, duhet që edhe sektori privat të kontribuojë në këtë fushë në mënyrë që të mundësohet një adresim më i mirë i nevojave të tregut të punës.

Kurse Lah Nitaj, drejtor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, ka përmendur arritjet e institucionit të cilin ai drejton, duke theksuar nevojën për ngritje të kapaciteteve njerëzore përmes një bashkëpunimi të mirëfilltë të sektorit publik dhe atij privat. Ai ka theksuar se, fatmirësisht, Kosova ka Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve që është në linjë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, mirëpo duhet të punohet më tej që të nxiten institucionet e arsimit në vend, në veçanti që shkollat profesionale që t'i ndjekin procedurat e akreditimit. Nitaj ka bërë me dije se katër qendra të kompetencës tanimë janë në proces e sipër të akreditimit.

Sharon Hart, presidente e RIT Kosovo (AUK), ka theksuar se Kosova ballafaqohet me një problem serioz i cili, nëse nuk trajtohet, do të zhvillohet në përmasa të cilat do të ndikojnë në shoqërinë në tërësi. Hart ka thënë se hulumtimet e zhvilluara së fundi nga organizata të ndryshme në vend tregojnë se rinia ka prirje të migrojë drejt vendeve të zhvilluara në kërkim të mundësive të punësimit, gjë që mund ta përkeqësojë edhe më tej situatën sa i përket boshllëkut të shkathtësive në vend. Ai ka theksuar rëndësinë e ndërtimit të urave të bashkëpunimit mes institucioneve private dhe publike të arsimit me sektorin privat në vend, si një hap kyç për krijimin e një fuqie punëtore që u përshtatet nevojave të tregut.

Tim Sparkman, drejtor i Projektit Enhancing Youth Employment, ka sqaruar rolin që projekti ka në këtë fushë, duke potencuar se procesi i liberalizimit të vizave pritet të ndikojë në disponueshmërinë e fuqisë së kualifikuar punëtore në vend. Sparkman ka pohuar se shkollimi profesional duhet të kultivohet dhe promovohet më tej te të gjitha palët e interesit, marrë parasysh suksesët që shtetet si Gjermania apo Zvicra kanë pasur në këtë aspekt përmes sistemit dual të arsimit. Sparkman theksoi se Kosova ka një potencial të madh për të zhvilluar një fuqi punëtore të kualifikuar, duke marrë parasysh edhe angazhimin e drejtorëve të shkollave me të cilat projekti i tij punon për t'i adresuar çështjet në lidhje me aftësimin e fuqisë punëtore.

## Ministri Hamza vlerëson lart ndihmën dhe kontributin e Suedisë për Kosovën

PRISHTINË, 21 SHTATOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të premten në takim njoftues ambasadoren e Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck Ahliny, me të cilën ka diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve në fushën e financave dhe ekonomisë.

Ministri Hamza, duke uruar ambasadoren Ahliny për detyrën, e falënderoi atë për ndihmën dhe kontributin që shteti suedez ka dhënë dhe vazhdon të japë për institucionet e Kosovës, për implementimin e projekteve, përmes të cilave shteti suedez i ndihmon Kosovës për zhvillimin e saj, si dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, në veçanti në fushën e regjistrimit të pronave të paluajtshme.

Ndërsa ambasadorja e Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck Ahliny, ka falënderuar ministrin Hamza për pritjen dhe ka shprehur gatishmërinë e saj dhe të shtetit suedez për ta rritur bashkëpunimin ekonomik dhe politik ndërmjet dy shteteve.



# Rreshteri amerikan mban ligjëratë për sigurinë në Kaçanik

KAÇANIK, 21 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka pritur në takim rreshterin Braden Schrag, ekspert i sigurisë për komunitet, i ftuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë.
Ilazi e ka falënderuar rreshterin amerikan për gatishmërinë e tij për ta ndarë përvojën dhe përvojën profesionale me aktorë të sigurisë në Kaçanik.
Pas këtij takimi rreshteri Schrang ka mbajtur një ligjëratë, në të cilën ka shtjelluar disa çështje që kanë të bëjnë me sigurinë, duke përfshirë policimin në bashkësi dhe parandalimin e terrorizmit. Po ashtu, ai ka treguar se si të bëhet bashkësia imune ndaj rezistimit të formave të ekstremizmit dhe si të bëhet ngritja e mekanizmave dhe nismave të ndryshme për ta ruajtur sigurinë publike.
Gjatë kësaj ligjërate rreshteri Schrag ka theksuar rëndësinë e policisë së komunitetit si dhe bashkëpunimin me qytetarët dhe me grupe të ndryshme të komunitetit si shoqëria civile, bashkësitë fetare etj. Ndërsa komandanti i Stacionit të Policisë në Kaçanik, Afrim Halili, ka shprehur përkushtimin e institucioneve të sigurisë për mbrojtje të rendit publik.





# Përurohet pllaka përkujtimore e doktor Lec Gradicës

SKENDERAJ, 21 SHTATOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka marrë pjesë të premten në ceremoninë e zbulimit të pllakës përkujtimore të doktor Lec Gradicës, i cili ka rënë heroikisht 20 vjet më parë. Me këtë rast, Veseli ka thënë se Lec Gradica ka dhënë jetën e tij për t'i shpëtuar të plagosurit. "Lec Gradica, ndër të parët që iu përgjigj thirrjes së lirisë, ishte mjeku i plagëve të lirisë dhe në fund edhe vetë u bë dëshmor i saj. Ai dha jetën për t'i shpëtuar të plagosurit. Ai dha jetën që të tjerët ta vazhdojnë luftën, deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës. Dhe, ëndrra e tij u bë realitet. Sot jemi këtu për ta nderuar veprën e tij, që paraqet shembullin më sublim se si jetohet dhe punohet për atdheun", ka theksuar Veseli.
Për ta nderuar veprën e doktor Gradicës, zyrtarë të Komunës së Skenderajt kanë vënë kurora me lule te varri i tij në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve në fshatin Marinë të Skenderajt.
Doktor Lec Leci, i njohur si Lec Gradica, ka rënë heroikisht duke shëruar plagët e luftëtarëve dhe popullatës në malet e Qyqavicës. Ai ishte ndër mjekët e parë që iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke mos e vënë në diskutim për asnjë çast profesionin e tij prej mantelbardhi edhe në kohën kur UÇK-ja vepronte ilegalisht.



# Gjilani shënon Ditën Ndërkombëtare të Paqes

Gjilan, 21 shtator (ER) - Komuna e Gjilanit ka shënuar të premten me një aktivitet simbolik Ditën Ndërkombëtare të Paqes, në të cilin ishin të pranishëm fëmijë të shkollave që kanë lexuar thënie të figurave të njohura të botës për paqen dhe lirinë në përgjithësi. Hanumshahe Rexhepaj, zyrtare për të drejtat e fëmijëve, ka thënë se së bashku me Asamblenë e Fëmijëve që është e përbërë nga nxënës të shkollave fillore dhe të mesme prej të gjitha komuniteteve, kanë lexuar këto thënie, njëkohësisht kanë bartur mesazhin për ndërtimin e paqes së qëndrueshme dhe një jetë më të mirë për të gjithë. Kurse Olti Suliqi nga asambleja e fëmijëve ka potencuar rëndësinë e rritjes së fëmijëve në paqe të përbashkët dhe liri ku secili fëmijë ka të drejtë të shprehjes, shkollimit, shëndetit dhe një ardhmërie më të mirë.

# Nis nderimi i shkollës së re në fshatin Tërrnje të Therandës

THERANDË, 21 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka marrë pjesë në vënien e gurthemelit të shkollës se re në fshatin Tërrnje të kësaj komunë. Me këtë rast ai ka bërë me dije se kjo shkollë do të jetë gati më 1 shtator të vitit 2019. "Fshati Tërrnje do ta gëzojë shkollën e re. Sot e vendosëm gurthemelin. Vitin e ardhshëm, më 1 shtator 2019, do ta përurojmë. Mbajeni mend, ky premtim do të realizohet", ka deklaruar Muharremaj. Në ceremoninë e vendosjes së gurthemelit të kësaj shkolle ka marrë pjesë edhe ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi. Po ashtu, Muharremaj ka marrë pjesë në hapjen e rrugës së vjetër të Shpenadis e cila i lidhë fshatrat Sallagrazhdë - Greikoc - Gelancë. Ai ka thënë se kjo rrugë do të jetë të zhvillimit të bujqësisë. "Ky investim do të jetë edhe në të ardhmen", ka thënë ai.



# Referendumi, pjesëmarrja dhe vota pro sjellin një faqe të re për Maqedoninë dhe mbarë rajonin



Prof. Lisen BASHKURTI

Dita e referendumit në Maqedoni po afrohet. Në fakt, është dita e kthesës së madhe që do të shënojë një faqe të re për Maqedoninë dhe mbarë rajonin. Nga pjesëmarrja dhe vota e qytetarëve të Maqedonisë varet e ardhmja e këtij shteti, e paqes, e stabilitetit, e demokracisë dhe shumetnisë, e prosperitetit ekonomik për mbarë qytetarët e tij dhe e integrimit në NATO dhe Bashkimit Evropian.

Nga pjesëmarrja dhe vota në referendum në një masë të konsiderueshme shënohet një faqe e re edhe për mbarë Ballkanin Perëndimor, zgjidhet një nyje ballkanike, kapërcehet një udhëkryq i rrezikshëm, tejkalohet një ngërç afër 20-vjeçar, hapet një erë e re në politikat e fqinjësisë së mirë në Ballkan dhe në kooperimin rajonal.

Fushata referendare po ecën për mirë. Ka një aktivizim të aktorëve kryesorë politikë, shtetërorë dhe jo shtetërorë, të shoqërisë civile, të medies dhe të njerëzve me ndikim opinional. Qeveria dhe mazhoranca po bëjnë një komunikim e informim të matur me shumë vlerë dhe pa propagandë. Faktorët opozitarë kohët e fundit hoqën dorë nga apeli për bojkot dhe me kujdes po ua lënë qytetarëve vullnetin për pjesëmarrje.

Faktori etnik shqiptar, në mazhorancë dhe në opozitë, më së shumti duket mjaft i afruar ndër vete në favor të pjesëmarrjes në referendum dhe votës pro referendare. Në klimën para referendare si rrallë herë shqiptarët dhe maqedonët, sikundër edhe komunitetet e tjera etnike, duket se janë pranë njëri-tjetrit për të mbështetur një pjesëmarrje të gjerë në referendum dhe për të votuar pro tij. Mesa duket vetëdija qytetare po ngrihet mbi atë etnike, fryma euroatlantike po dominon atë ballkanike. Në këtë qasje pozitive ka ndikuar drejtpërdrejt rruga drejt integrimit të shpejtë të Maqedonisë në NATO dhe hapja e negociatave për pranimin edhe në BE. Pra, ka një vetëdije euroatlantike të ngritur në politikën dhe shoqërinë e shtetit të Maqedonisë.

Në klimën pozitive të krijuar brenda vendit kontributin kryesor e ka Qeveria e Zaevit, politika, qëndrimet dhe sjellja e së cilës po tregojnë një filozofi të re politike të mbështetur në vlera dhe interesa mbarë qytetare, pa dallime politike dhe etnike dhe larg ndikimeve gjeopolitike joeuroatlantike. Duke tejkaluar me prudencë krizat politike dhe institucionale të pak kohe më parë, kryeministri Zaev dhe Qeveria e tij, së bashku me faktorë të tjerë institucionalë politikë e shoqërorë, po japin një model se si mund të kapërcehen me vullnet politik kriza që për dy dekada e mbajti vendin në një qark të mbyllur pa rrugëdalje. Zaevi dhe Qeveria e tij po japin mesazhe mjaft pozitive politike-diplomatike për mbarë Ballkanin Perëndimor.

Klimën pozitive të referendumit po e mbështesin fuqishëm edhe faktorët politikë dhe diplomatikë më të rëndësishëm ndërkombëtarë. NATO-ja, BE-ja, ShBA-ja, Gjermania dhe shtetet e tjera evropiane me ndikim janë përfshirë drejtpërdrejt në fushatën pro referendare nëpërmjet veprimeve e qëndrimeve diplomatike të qarta e të drejtpërdrejta. Shkupi është kthyer në një skenë dinamike të diplomacisë publike euroatlantike bashkëkohore. Nisur nga shumë përvoja të hidhura referendare në rajon, por edhe në Evropë, këtë herë duket se tërë faktorët me ndikim euroatlantik kanë 'zbarkuar' në Shkup me të njëjtat politika, veprime e qëllime të njësuara. Duket se rasti i Maqedonisë ka bashkuar më tepër se çdo rast tjetër në Ballkanin Perëndimor NATO-BE-ShBA-Gjermani etj., pra faktorët më të fuqishëm euroatlantik.

Në këtë situatë politike edhe vendet e Ballkanit Perëndimor duket se kanë qëndrime të unifikuara pro referendumit në Maqedoni. Gjithë vendet e rajonit, fqinjët e drejtpërdrejtë të Maqedonisë, Shqipëria, Kosova, Serbia, Mali i Zi, por edhe të tjerë kanë ndërmarrë vizita diplomatike të larta pro referendare. Të gjithë e kanë vlerësuar këtë referendum si erë e re për Maqedoninë dhe mbarë Ballkanin Perëndimor.

Ditët e fundit fitorja e Syrisas në Greqi u dha mesazhin më të fuqishëm dilemave greke. Qytetarët grekë me votën pro kryeministrit Cipras dhe koalicionit të tij afirmuan edhe marrëveshjen greko-maqedone për emrin e Maqedonisë. Qarqet nacionaliste dhe ekstremiste duket se ngelen në 'kalendat greke' edhe këtë radhë, duke i krijuar shansin historik Ciprasit dhe Qeverisë së tij t'i vijojnë reformat e brendshme të suksesshme, por edhe politikat e fqinjësisë së mirë, midis të cilave marrëveshjen ndërqeveritare greko-maqedone që është nga më të rëndësishmet. Edhe kryeministri Cipras, sikundër Zaevi, po japin mesazhe me rëndësi euroatlantike për fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunim rajonal. Janë dy liderë që po sjellin të njëjtën filozofi politike qytetare evropianiste në shoqëritë e tyre të brendshme dhe në mbarë Ballkanin Perëndimor.

Fushata referendare ditët e fundit është me rëndësi të veçantë. Shtimi i informimit dhe komunikimit me qytetarët është instrumenti kryesor i garantimit të pjesëmarrjes së gjerë dhe votës pro në referendum. Është e kuptueshme që faktorë të brendshëm, por edhe gjeopolitikë, me prani dhe ndikim në jetën politike dhe shoqërore në Maqedoni po aktivizohen në mënyra shumë të mbrojtura kundër pjesëmarrjes në referendum dhe votës kundër tij.

Këta faktorë gjeopolitikë të rrezikshëm nuk duhen nënvlerësuar deri në përfundim të referendumit, sepse kohët e fundit po tregojnë se edhe në demokraci shumë të fuqishme dhe të konsoliduara intervenimet e aktorëve dhe faktorëve gjeopolitikë kundër euroatlantikë po ndikojnë me rrugë e metoda të sofistikuara rezultatet zgjedhore dhe referendare në shumë vende. Ngjallja e nacionalizmit, populizmit, euroskepticizmit janë, ndër të tjera, edhe ndikim i këtyre faktorëve gjeopolitikë kundër euroatlantikë.

Ndonëse mund të themi se nuk jemi në rendin e Luftës së Ftohtë, mund të deklarohemi pa hezitim që nuk jemi as në rendin e ri botëror. Rendi botëror po përjeton një tranzicion ku po bashkëjetojnë në mënyrë ballafaquese recidivat e Luftës së Ftohtë dhe sindromat e rendit të ri, po konfrontohen interesat dhe doktrinat gjeopolitike me vlerat e tendencat integruese e globaliste.

Në këtë situatë Maqedonia është shndërruar në një rast me rëndësi ndërkombëtare. Nga pjesëmarrja në referendum dhe nga rezultati i tij do të kenë përfitime më të mëdha qytetarët e Maqedonisë, do të kenë më shumë paqe e stabilitet, më shumë demokraci dhe prosperitet ekonomik e social dhe do t'i forcojnë pozitat e tyre në hapësirën euroatlantike nëpërmjet integrimit të shpejtë në NATO dhe avancimit të integrimit në BE. Gjithë Ballkani Perëndimor do të ketë impakte pozitive nga pjesëmarrja e gjerë në referendumin në Maqedoni dhe vota pro tij. Kësisoj Maqedonia do të ndikojë të afrojë më shumë gjithë rajonin tonë me familjen e kombeve euroatlantike.

## Bytyqi viziton disa shkolla në Klinë, premton kushte më të mira për nxënësit

KLINË, 21 SHTATOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar të premten Komunën e Klinës, ku është pritur nga kryetari Zenun Elezaj, me të cilin ka biseduar për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe më pas ka vizituar tri shkolla në këtë komunë. Fillimisht, ministri Bytyqi ka vizituar Shkollën Fillore "Ismet Rraci", ku uroi që nxënësit të angazhohen dhe të mësojnë shumë, sepse është për të mirën dhe të ardhmen e tyre, ndërsa i këshilloi ata të kërkojnë sa më shumë nga mësimdhënësit dhe të fitojnë dijen e merituar.

Ministri, më pas, ka vizituar objektin e ri të kësaj shkolle, i cili është duke u ndërtuar dhe do të ofrojë hapësirë moderne të mësimit për 1 500 nxënës që ndjekin mësimet në këtë shkollë.

Në vazhdim, ministri Bytyqi ka vizituar Shkollën e Mesme Teknike "Fehmi Agani", me ç'rast mori pjesë në një orë të punës praktike në lëndën "Elektronikë".

Ministri u shpreh i kënaqur me punën që po bëhej nga nxënësit, ndërsa tha se drejtimet e tilla profesionale ofrojnë mundësi të shumta për punësim të të rinjve dhe do të ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.



Bytyqi ka theksuar se duhet të vazhdohet pajisja e shkollave profesionale me kabinete të nevojshme, në mënyrë që nxënësit të përfitojnë shkathtësi të duhura, ndërsa ka theksuar se MAShT-i në bashkëpunim me komunat mbetet të angazhohen që të krijojnë më shumë mundësi për punën praktike në ndërmarrje.

Ministri Bytyqi ka vizituar edhe Shkollën Fillore "Emin Duraku" në Sverkë, ku ka pohuar se MAShT-i është e përkushtuar të krijojë kushte të mira dhe të ofrojë mundësi të zhvillimit profesional edhe për mësimdhënësit.

## Kina kritikon sanksionet amerikane për armët ruse

PEKIN, 21 SHTATOR - Kina shprehu të premten indinjatën pas sanksioneve amerikane kundër armatimeve ruse.
Uashingtoni njoftoi të enjten në mbrëmje se kishte sanksionuar për herë të parë një entitet të huaj për blerjen e armëve ruse, më saktë bëhet fjalë për një njësi të ushtrisë kineze, që ka blerë avionë luftarakë dhe raketa tokë-ajër. "Ky gjest i ShBA-së shkel rëndë parimet themelore të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe dëmton seriozisht marrëdhëniet mes dy vendeve dhe ushtrive të tyre", deklaroi gjatë një konference me gazetarë zëdhënësi i diplomacisë kineze, Geng Shuang duke theksuar se Pekini kishte paraqitur menjëherë protestat e tij në Uashington. "Ne i bëjmë thirrje fuqishëm ShBA-së të korrigjojë menjëherë këtë gabim dhe t'i tërheqë të ashtuquajturat sanksione. Përndryshe ShBA-ja duhet t'i paguajë pasojat", paralajmëroi zëdhënësi i diplomacisë kineze.



# May: BE-ja duhet ta respektojë Britaninë në negociatat për Brexitin

Kryeministrja britanike Theresa May në një deklaratë ka thënë për liderët e BE-së se kundërshtimi i planit të saj pa ofruar alternativë në këtë fazë të vonë të negociatave është i papranueshëm



LONDËR, 21 SHTATOR - Kryeministrja britanike Theresa May ka thënë se Bashkimi Evropian duhet ta trajtojë Mbretërinë e Bashkuar me "respekt" në negociatat për Brexitin. Në një deklaratë të nisur nga Downing Street, ajo ka thënë për liderët e BE-së se kundërshtimi i planit të saj pa ofruar alternativë në këtë fazë të vonë të negociatave është i papranueshëm. Përveç të tjerash, May ka thënë se "nuk do ta përmbysë rezultatin e referendumit dhe nuk do ta ndaj shtetin tim".
Sekretari britanik për Brexit, Dominic Raab, ka thënë se nuk ka alternativë të besueshme në tavolinë nga bisedimet e BE-në. Ai ka shprehur dyshim rreth seriozitetit të liderëve të BE-së lidhur me këto negociata. Raab ka thënë për BBC-në se neve na u janë kundërshtuar planet pa ndonjë sqarim se pse. Sipas tij, Qeveria britanike do të "vazhdojë të jetë e qetë dhe t'i mbajë negociatat në frymën e besimit të mirë".
Britania e Madhe pritet të largohet nga Bashkimi Evropian më 29 mars të vitit 2019. May ka thënë se plani i saj për Britaninë dhe BE-në për të zbatuar "rregullore të njëjtë" për mallra, por jo edhe shërbime, është rruga e vetme kredibile për të anashkaluar një kufi të ashpër në mes të Irlandës Veriore dhe Republikës së Irlandës. Mirëpo plani i May është kundërshtuar edhe nga anëtarë të partisë së saj, të cilët thonë se një plan i tillë do të krijonte kompromise për sovranitetin e Britanisë.
Ndërsa presidenti i Këshillit Evropian ka thënë në një konferencë për media, pas takimit të liderëve të BE-së në Salsburg, se ka pasur disa "elemente pozitive" në planin e kryeministres britanike. Mirëpo ai, po ashtu, ka deklaruar se liderët evropianë janë pajtuar për ta rishkruar propozimin, pasi "plani për bashkëpunim ekonomik nuk do të funksionojë".
Kryeministri irlandez Leo Varadkar ka thënë për RTE-në të premten se "jam duke punuar çdo ditë sikurse njerëzit në Evropë dhe Qeverinë britanike për të mënjanuar një Brexit pa marrëveshje".
Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian janë duke tentuar të arrijnë një marrëveshje për Brexitin deri në mes të muajit nëntor si dhe po synojnë t'i ikin kufirit të ashpër në mes të Republikës së Irlandës dhe Irlandës Veriore, mirëpo ende nuk kanë arritur gjuhë të përbashkët në këtë çështje.

# Trumpi nuk publikon dokumentet për hetimet rreth Rusisë



UASHINGTON, 21 SHTATOR - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë të premten se nuk do të publikohen dokumentet për hetimet federale rreth Rusisë pavarësisht se ditë më parë ka urdhëruar që ato të bëhen publike, transmeton "Reuters". Ai ka cituar Departamentin Amerikan të Drejtësisë kur ka bërë këtë njoftim, duke thënë se një gjë e tillë mund t'i dëmtonte hetimet. Trumpi ka thënë përmes një postimi në "Twitter" se një inspektor i përgjithshëm i këtij Departamenti duhet t'i rishikojë të gjitha dokumentet. "Nëse ka nevojë unë në fund (pas rishikimit) mund t'i bëj publike dokumentet", ka thënë Trumpi në "Twitter".
Përfaqësuesit e Zyrës së Departamentit të Drejtësisë nuk u janë përgjigjur kërkesave për koment. Trumpi ka bërë thirrje për publikim të dokumenteve të hënën, duke nxitur kritika nga demokratët dhe palët e tjera se ai dhe aleatët e tij janë duke politizuar hetimet për ta mbrojtur Shtëpinë e Bardhë para mbajtjes së zgjedhjeve për Kongres në muajin nëntor.
Trumpi ka kundërshtuar bashkëpunimin me Rusinë dhe Moska ka bërë të njëjtën gjë, pavarësisht se agjencitë amerikane të inteligjencës kanë thënë se Rusia është përfshirë në procesin zgjedhor të ShBA-së.

## Mbi 100 persona të vdekur pas fundosjes së tragetit në Tanzani

TANZANI, 21 SHTATOR - Të paktën 136 persona kanë vdekur pas përmbytjes së një trageti në Liqenin Viktoria në Tanzani, në të cilin gjendeshin qindra persona, kanë thënë zyrtarët. Fati i shumë personave të tjerë nuk dihet, mirëpo ka shqetësime që më shumë se 200 persona mund kenë vdekur pas fundosjes së tragetit.
Ekipet e shpëtimit kanë nisur punën sërish të premten, pasi kanë ndalur kërkimet gjatë natës. Trageti i tipit MV Nyerere është fundosur afër Ishullit Ukara, pasi ishte nisur nga Bugorora. Trageti ka qenë i stërmbushur me njerëz, kjo njëherësh konsiderohet arsyeja e fundosjes së tij.
Mediet lokale kanë thënë se kapaciteti i tragetit ka qenë për 100 persona, mirëpo në të mendohet të kenë qenë më shumë se 400.
Të dhënat e sakta të personave të vdekur dhe të atyre që mund të kenë qenë në traget nuk dihen, pasi agjencia e lajmeve "Reuters" ka thënë se personi që ka shpërndarë biletat për këtë udhëtim po ashtu ka vdekur, së bashku me pajisjen që ka pasur të dhënat e biletave.



# Fjala e Lulzim Tafës me rastin e marrjes së çmimit 'Mihai Eminescu'

*E nderuara Juri e Festvalit,*
*Të dashur kolegë,*
*Poetë dhe lexues të poezisë,*
*Zonja dhe zotërinj!*

E pranoj këtë çmim, duke qenë i nderuar me vendimin e kësaj Jurie të respektuar që këtë çmim ta ma japë mua. Duhet t'ju bëj me dije se poezi kam filluar të shkruaj sa isha fëmijë. Jam rritur me poezinë dhe po plakem me të. Unë gjithmonë i kam qëndruar besnik poezisë. Në jetë kam bërë edhe punë të tjera, qoftë si profesor, por edhe punë menaxheriale çfarë është edhe pozita e rektorit, por edhe aktivitete të fushës së të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së kafshëve por, duhet të theksoj se, edhe kur kam vepruar në fusha të tjera, gjithë jetën time kam frymuar si poet. Jam ndier poet dhe vazhdoj të jetoj si i tillë.



Ky çmim më bën nder mua dhe letërsisë që i takoj. Unë i takoj letërsisë së Kosovës, letërsisë shqipe të Kosovës. Administratorët e festivalit më thanë se unë këtu do të jem nën logon e Shqipërisë. Edhe kjo më bën nder, sepse letërisa shqipe është një dhe unë i takoj asaj letërsie. Vendi prej nga vij unë, pra Kosova, ka shumë poetë të mirë të cilët, po ashtu, me krijimtarinë e tyre janë të njohur për lexuesin në Evropë e më gjerë. Unë si fëmije e mësova misionin që ka një poet, pra jo vetëm për të bashkuar fjalë që kurrë më përpara nuk kanë qenë bashkë njëra me tjetrën, por edhe për t'i thënë gjërat bukur, njësoj si kur shkruan për dashurinë, gëzimin e jetën, njësoj si kur shkruan për trishtimin e vdekjen, e rëndësishme që ajo të thuhet bukur. Unë gjithmonë bëj përpjekje ta bëj këtë, prandaj e vlerësoj shumë këtë çmim. Ky çmim më jep më shumë siguri.

Gjatë krijimtarisë sime më shumë se tridhjetëvjeçare kam marrë edhe çmime të tjera, madje çmimin e fundit e kam marrë nga komuniteti malazez, një komunitet pakicë që jeton i respektuar në vendin tim. Në motivacionin e çmimit të tyre, që e mban po ashtu emrin e njërit prej shkrimtarëve më të njohur të letërsisë së Malit të Zi, përveç motivit letrar, ata kishin futur edhe angazhimin tim për paqe dhe afirmim të të drejtave të pakicave. Dhe, kjo më gëzoj, po aq sa edhe motivacioni për letërsi.

Vendi im para pak vitesh ka dalë nga një luftë e përgjakshme. Unë edhe atëherë kam qenë poet, kam shkruar për lirinë dhe paqen. Një ditë një konvoj militarësh erdhi dhe dogji shtëpinë time, edhe pse unë nuk isha luftëtar, unë isha poet. Ma dogji bibliotekën, librat, dorëshkrimet, fotografitë, kujtimet. Secili prej jush e di çdo të thotë për një poet t'i digjen dorëshkrimet, t'i digjen librat. Unë shkruaja për lirinë. Ata që m'i dogjën librat një ditë ikën nga vendi im, ndërsa unë vazhdova të shkruaj përseri për lirinë dhe paqen. Këtë e bëj edhe sot.

Fatkeqësisht, shumë shkrimtarë të Ballkanit në kohën e luftës u bënë krah i politikës. Në vend se të punonin për paqe, ata i frynin zjarrit të luftës. Ndodhi që një poet nga Ballkani të gjykohet dhe dënohet për krime kundër njerëzimit në një Gjykatë Ndërkombëtare. U gjykua dhe u dënua sepse ra në kundërshtim me vlerat e njerëzimit, në kundërshtim edhe me vlerat që ka letërsia.

Unë sot krijoj dhe punoj për t'i promovuar këto vlera qoftë si poet, qoftë edhe si një jurist. Loboj që të kemi ligje më të mira që mbrojnë dhe avancojnë jo vetëm të drejtat e njeriut, por edhe të kafshëve dhe të gjitha krijesave të Zotit në planetin tonë, edhe pse kjo në Ballkan nuk është e lehtë. Shpeshherë edhe jam paragjykuar.

Pse është i rëndësishëm ky çmim për mua?

E para, sepse e jep një juri kaq kompetente; e dyta, sepse më jepet në njërin prej festivaleve më të rëndësishme që mbahen në kontinentin tonë, pastaj sepse e mban emrin e Mihajl Emineskut, kolosit të madh jo vetëm të letërsisë rumune, por edhe të letërsisë botërore, ngaqë është e vërtetë se ne u takojmë letërsive që përfaqësojmë, por vlerat që përfaqëson letërsia janë universale. Ky festival ka shume vlera.

Ju faleminderit!

**Lulzim TAFA**







# Nënshkruhet memorandumi për zhvillimin arkivor dhe digjitalizimin e dokumenteve

PRISHTINË, 21 SHTATOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të premten në takim kryeshefin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave, Ramë Manaj. Në këtë takim ministri Gashi dhe kryeshefi Manaj kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për mbështetje financiare për projektin "Mbështetja për zhvillimin e veprimtarisë arkivore dhe ngritja e kuadrit profesional arkivor".



Memorandumi do të zbatohet gjatë vitit 2018, projekt për të cilin MKRS-ja do të investojë me vlerë financiare prej 8 000 eurosh. Qëllim i këtij memorandumi është krijimi i dokumenteve elektronike dhe aplikimi i normave bashkëkohore për zhvillimin e mëtutjeshme të veprimtarisë arkivore. Po ashtu, ky projekt do ta mbështesë ngritjen dhe aftësimin e kuadrit profesional arkivor të angazhuar në Agjencinë Shtetërore të Arkivave, por edhe të kuadrit arkivor në arkivat ndërkomunale. Ky aktivitet ka mbështetje të plotë në Ligjin për Arkivin Shtetëror dhe Standardet Ndërkombëtare te Arkivistikës.

Ministri Gashi ka vlerësuar se me nënshkrimin e këtij memorandumi kemi vazhduar më tutje mbështetjen për institucionin më të rëndësishëm të ruajtjes dhe mbrojtjes së dokumenteve shtetërore të cilat i mbesin si histori gjeneratave që vijnë. Ndërkaq, kryeshefi i Agjencisë Shtetërore të Arkivave, Manaj, e ka falënderuar ministrin për përkrahjen që ai po jep për institucionin që ai udhëheq dhe vënien e tij ndër prioritetet e ministrisë.

E jashtëzakonshme

## Kambana më e madhe e botës zbulohet në Poloni



Kambana më e madhe në botë është zbuluar në qytetin polak të Krakovës. Kambana peshon 55 tonë dhe do të instalohet në një vend të pelegrinazhit të madh në Brazil. "Vox Patris", katër metra e lartë dhe me diametër 4.5 metra, do të vendoset në Bazilikën e Atit të Përjetshëm në qytetin Trindade.

FOTO E DITES



Punëtorët korrin çaj në Son La, Vietnam. /nationalgeographic/

E rrallë

## Kirurgia 90-vjeçare



Është 90 vjeçe, por vazhdon ta ushtrojë profesionin. Alla Ilyinichna Levushkina është kirurgia më e vjetër jo vetëm në Rusi, por në gjithë botën. Në punën e saj 68-vjeçare si mjeke ajo ka kryer 10 mijë operacione dhe në të gjitha rastet çdo gjë ka shkuar me sukses. Veç rekordit të moshës, rekordi tjetër i saj është edhe suksesi në punë, pasi asnjë pacient nuk ka humbur jetën në duart e 90-vjeçares.

## BARSOLETA E DITËS



**- Qysh t'u dukë testi, vëlla?**
**- Shumë i vështirë. Fletën e lashë zbraztë.**
**- Edhe unë e lashë zbraztë.**
**- Kuku, tash profa mendon se kemi kopju.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

### "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky







**Në ora 18:00**

### "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

**Në ora 20:00 dhe 22:00**

### "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Edhe pse ju duket se keni përmirësuar strategjinë tuaj të veprimit, në fund të ditës do të bëni po të njëjtat gabime si gjithmonë.



**DEMI**
Sot do të përfundoni një punë të lënë përgjysmë dhe të pambaruar. Gjithçka do të varet nga mbështetja që do t'jua japin kolegët.



**BINJAKËT**
Jeni shumë kurioz si natyrë, por nuk duhet të kërkoni përgjigje për një surprizë që duan t'jua organizojnë.



**GAFORRJA**
Edhe personat me striktë sot do të prekën nga humori dhe energjia juaj, do të përçoni pozitivitet dhe duket se çdo vështirësi e fillimit do të zhduket.



**LUANI**
Nuk jeni të bindur që keni bërë zgjedhjet e duhura dhe kjo ndikon në rezultatin final të projekteve tuaja. Duhet të keni më shumë besim te vetja.



**VIRGJËRESHA**
Jeni mënjanuar pa dashjen tuaj nga persona me të cilët në të shkuarën keni ndarë kohë të vyer. Do të mundoheni ta rikuperoni raportin.



**PESHORJA**
Ju mungon koha fizike për t'i kënaqur të gjitha kërkesat që keni. Mbase një organizim më i mirë i ditës do t'ju sjellë edhe të mira shpirtërore.



**AKREPI**
Do të përballeni me një person sot që ka kërkuar një ballafaqim me ju. E keni të vështirë të pranoni një të vërtetë që mund ta lëndojë.



**SHIGJETARI**
Nëse nuk jeni në dijeni të një bisede ose të një situate të caktuar nuk duhet ta merrni përsipër përgjegjësinë që nuk është aspak e juaja.



**BRICJAPI**
Personat që ju duan nuk kanë menduar se zgjedhja juaj në disa çaste ka qenë e kushtëzuar nga rrethana të tjera.



**UJORI**
Po vini një shënjestër një person të caktuar sot, që mendoni se ka folur kundër jush. Do të shikoni që e vërteta është komplet ndryshe.



**PESHQIT**
Keni lënë dyer hapur për persona nga e kaluara juaj dhe në të ardhmen do të pendoheni për këto veprime. Arsyeja do të dalë më e fortë se ndjenja.

# Beyonce ushtron magjinë e zezë



Ish-bateristja e Beyonce ka bërë disa akuza të rënda rreth këngëtares. Timberly Thompson pretendon se 'Mbretëresha Bey' ka përdorur magjinë e zezë për t'i mbikëqyrur dhe kontrolluar financat e saj. Ndërsa tani Thompson ka ngritur padi dhe kërkon urdhër mbrojtje ndaj Beyonces. Në dokumentet e paraqitura në gjykatë ajo pretendon se ka punuar me këngëtaren si bateriste e grupit të saj për shtatë vjet.

# Gigi Hadid me fustan nusërie




Gigi Hadid sfiloi në "Milan Fashion Week" dhe si gjithmonë i ka lënë të gjithë pa fjalë. Modeluesja e famshme u shfaq veshur me një fustan nusërie mjaft modern. Në dorë mbante një tufe me lule dhe vello nusërie. Gigi dukej mahnitëse me fustanin e bardhë.



# Jorge Lorenzo kapet "mat". Kush është vajza misterioze?

Jorge Lorenzo po përfiton nga pauza në Moto GP pas Çmimit të Madh të San Marinos për t'i shijuar pushimet në plazhet e Formenteras. Piloti spanjoll është pikasur në shoqërinë e një vajzë të re shumë të bukur, me të cilën është kuptuar qartësisht se është në një lidhje. Jorge dhe femra misterioze që ka në krah janë fotografuar në deti, ku kanë kaluar pjesën më të madhe të ditës.



# Angelina Jolie dhe Brad Pitti takohen fshehurazi



Duket sikur Angelina Jolie dhe Brad Pitti po kthejnë një faqe të re në jetën e tyre. Megjithëse kanë qenë të angazhuar në një betejë të vështirë të kujdestarisë ndaj gjashtë fëmijëve të tyre që kur Jolie paraqiti për divorc më 20 shtator 2016, një burim ka raportuar se aktorja kohët e fundit ka takuar Pittin për t'i përmirësuar marrëdhëniet e tyre si prindër. "Brad dhe Angelina zhvilluan një takim sekret në shtëpinë e saj", ka thënë ky burim.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | BRIGHTON - TOTTENHAM | 2 | CRYSTAL PALACE - NEWCASTLE | GG | ASTON VILLA - SHEFF WED | 1 |

# Flamurtari nuk e mendon humbjen ndaj Feronikelit

Derbi Flamurtari - Feronikeli mund të sjellë ndryshime në krye të renditjes tabelore në Superligën e futbollit. Kuqezinjtë kërkojnë rezultat pozitiv për të mbetur liderë edhe pas xhiros së gjashtë, kurse "Nikli" synon fitoren për ta zbritur Flamurtarin nga froni

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Xhiroja e gjashtë në elitën e futbollit të Kosovës sjell edhe dy ndeshje derbi. Sot (e shtunë), Flamurtari, që është lider në Ipko Superligë, e pret skuadrën e Feronikelit, kurse synimi i kuqezinjve nga kjo ndeshje derbi është të dalin të pamposhtur.
Trajneri Arsim Thaqi pret lojë dhe rezultat të mirë nga skuadra e tij, ashtu sikurse në pesë javët e parë. "Synimi ynë është të bëjmë lojë të mirë ashtu siç kemi treguar në pesë javët e para të këtij sezoni. Sa i përket rezultatit, besojmë se edhe në këtë takim do të marrim pikë", ka thënë Thaqi. Synime të mëdha në ndeshjen ndaj Flamurtarit ka edhe Feronikeli.
Mesfushori Alburtint Morina është optimist se skuadra nga Drenasi mund të shënojë fitore në kryeqytet dhe t'i zbresë kuqezinjtë nga froni. "Sa i përket Flamurtarit, mendoj se do të jetë një ndeshje shumë e vështirë për faktin se kjo skuadër po kalon nëpër një formë të mirë, por besoj se kemi potencial për ta marrë rezultatin që dëshirojmë dhe ta rrëzojmë Flamurtarin nga pozita e parë", ka deklaruar Morina.
Skuadra e Feronikelit, prej pesë ndeshjeve të luajtura, ka regjistruar tri fitore dhe dy barazime, me një golaverazh prej tetë golave të shënuara dhe vetëm një të pranuar.



Të shtunën zhvillohen edhe dy ndeshjet e tjera Liria - Llapi dhe KEK-u - Drenica, derisa të dielën zhvillohen dy ndeshje: derbi në mes të Dritës dhe Prishtinës dhe ndeshja tjetër Ferizaj - Gjilani.

### Ballkani - Trepça '89 përfundon pa fitues

Ballkani dhe Trepça '89 kanë luajtur baras dhe pa gola në ndeshjen e javës së gjashtë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja e zhvilluar në Suharekë solli shumë raste shënimi, por asnjëra skuadër nuk arriti ta shënojë golin e fitores. Vendësit patën disa raste shënimi në pjesën e parë, por ato përfunduan pa sukses. Ballkani nga minuta e 50 luajti pa një lojtar, pasi Egzon Shabani u ndëshkua me karton të kuq. Rezultati i kësaj ndeshje përfundoi me rezultat 0-0.

**IPKO SUPERLIGA**

Ballkani - Trepça '89 0-0
Të shtunën takohen:
15:45 Flamurtari - Feronikeli
15:45 Liria - Llapi
15:45 KEK-u - Drenica

Të dielën takohen:
15:45 Drita - Prishtina
15:45 Ferizaj - Gjilani

**LIGA E PARË**

Të shtunën takohen:
Trepça - Bashkimi (K)
Vitia - Vushtrria
Onix - Fushë-Kosova
Vëllaznimi - Ramiz Sadiku

Të dielën takohen:
Vllaznia - 2 Korriku
Kika - Drenasi
Arbëria - Dukagjini
Besa - Istogu

# Melisa ka synime të mëdha në Lojërat Olimpike Verore

"Besoj se do të jem në formën time më të mirë deri para fillimit të Lojërave Verore Olimpike për të Rinj, 'Buenos Aires 2018'. Nëse gjithçka shkon sipas planit, unë besoj se do të kem paraqitje të mirë, ku së paku do ta përmirësoj rekordin e Kosovës", ka thënë Melisa Zhdrella

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Melisa Zhdrella është notarja e vetme që do ta përfaqësojë Kosovën në Lojërat Olimpike Verore për të Rinj, "Buenos Aires 2018", që mbahen prej 6-18 tetor në Buenos Aires të Argjentinës. 18-vjeçarja prej disa ditësh është duke u përgatitur në Durrës të Shqipërisë falë mbështetjes që Komiteti Olimpik i Kosovës ua ka dhënë federatave për përgatitje jashtë vendit të sportistëve që do ta përfaqësojnë vendin tonë në "Buenos Aires 2018".
Krahas Zhdrellës, që është ftuar me ftesë, në LOV për të rinj, Buenos Aires 2018, do të marrin pjesë edhe: peshëngritësi Bleron Fetaovski, boksieri Erdonis Maliqi dhe atleti Muhamet Ramadani që, po ashtu, janë ftuar me ftesë për shkak të Univerzalitetit. E vetmja me normë



Olimpike është xhudistja Erza Muminoviq. "Jemi duke stërvitur në qendrën stërvitore në Durrës bashkë me trajnerin tim, Enver Hajdredini. Stërvitjet po mbahen sipas planit, kushtet e pishinës janë në nivel. Jemi duke ushtruar dy herë në ditë dhe çdo gjë është në rregull", ka deklaruar Zhdrella për faqen zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës.
Notarja e klubit Termopan do të garojë në disiplinën 50 metra krol, në të cilën synon të paktën ta thyejë rekordin e Kosovës. "Besoj se do të jem në formën time më të mirë deri para fillimit të Lojërave Verore Olimpike për të Rinj, 'Buenos Aires 2018'. Nëse gjithçka shkon sipas planit, unë besoj se do të kem paraqitje të mirë, së paku do ta përmirësoj rekordin e Kosovës", ka thënë Melisa Zhdrella.
Melisa ka gjasa të garojë edhe në disiplinën 50 metra bretkosë, për çka KOK është duke pritur konfirmim nga organizatori. Zhdrella kishte përfaqësuar Kosovën edhe në Lojërat Evropiane "Baku 2015". Komiteti Olimpik i Kosovës merr pjesë për herë të parë në Lojërat Olimpike Verore për të Rinj.

# Sot fillon kampionati në basketboll

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Edicioni i ri në Superligën e Kosovës në basketboll do të fillojë në këtë fundjavë. Dy ndeshje do të luhen të shtunën, kurse të dielën është në program vetëm një ndeshje, derisa dueli në mes të Z Mobile Prishtinës dhe Trepçës do të zhvillohet më vonë. Të shtunën me fillim nga ora 15:00 Lipjani e pret Ponte Prizrenin, ndërsa takimi do të luhet në Palestrën e Sporteve "Bill Klinton" në Ferizaj. Ndërkaq të dielën do të zhvillohet derbi i xhiros së parë, ku Bashkimi është nikoqir i Golden Eagle Yllit, takim ky që do të luhet në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren, duke filluar nga ora 17:00. Të gjitha ekipet e elitës së basketbollistë kosovarë janë përforcuar si me lojtarë vendorë, po ashtu edhe me ata të huaj, andaj pritet që konkurrenca në këtë edicion të jetë dukshëm më e fortë se ajo e një viti më parë. Duhet theksuar se kampione në fuqi në konkurrencën e meshkujve është skuadra e Bashkimit, kurse Z Mobile Prishtina është fituese e Kupës së Kosovës. Kjo e fundit e ka fituar trofeun e Superkupës së Kosovës në prag të edicionit të ri.

# Llapi s'heq dorë nga Bylbyl Sokoli

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Skuadra e Llapit ka konfirmuar se trajneri Bylbyl Sokoli do të jetë në krye të shtabit teknik. Sipas njoftimit të klubit, Sokoli nuk kishte dhënë dorëheqje dhe, pavarësisht prej raportimit të medieve, ai vazhdon ta ketë përkrahjen e aksioneve të klubit. "Bordi i Aksionarëve ia rikonfirmon edhe një herë gjithë opinionit dhe dashamirëve të futbollit dhe të KF Llapit, se Bylbyl Sokoli ka përkrahjen e plotë nga Bordi i Aksionarëve dhe do të ketë mbështetjen deri në përfundimin e kontratës. Ne ia kemi besuar detyrën duke u bazuar në përgatitjen profesionale dhe sportive", thuhet në njoftimin e Llapit.



## Perez: Juve bëri ofertën më të mirë për Ronaldon



MADRID, 21 SHTATOR - Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, e zbuloi arsyen pse pranoi ta ulte shumëfish klauzolën e largimit të Cristiano Ronaldos, pastaj shitjen e tij të mëvonshme te Juventusi. Presidenti i Realit shpjegoi gjithçka që ndodhi në marshimin e Cristiano Ronaldos drejt kampionëve të Italisë dhe zbuloi arsyen pse u detyrua ta ulte klauzolën e tij të largimit: "Klauzolat që Real Madridi iu vendos lojtarëve të tij janë për ata që paguajnë". "Shitja më e shtrenjtë e këtij viti ka qenë ajo e Cristianos. Kur të gjithë besuam se gjëja më e mirë ishte ajo që ndodhi, ne arritëm një marrëveshje. Për të nuk na dha askush më shumë se 100 milionë euro. Pra, oferta e Juventusit ishte më e mira financiarisht. Ai donte të largohej, ndërsa ne nuk kemi pasur shumë oferta", ka deklaruar Perezi.

# Xhardan Shaqiri s'do të shkojë në Beograd me Liverpoolin



LIVERPOOL, 21 SHTATOR - "Goal.com" përmes një shkrimi në faqen e vet jep të gjitha arsyet se pse Xherdan Shaqiri nuk do të udhëtojë me ekipin e vet të ri, Liverpool, në udhëtimin më 6 nëntor në Beograd ndaj Crvena Zvezdës, ndeshje e vlefshme për Grupin C në Ligën e Kampionëve. Xherdan Shaqiri bashkë me Granit Xhakën ishin në qendër të polemikave gjatë Kupës së Botës së kësaj vere, pas festimit të tyre me "shqiponjë" në dy golat që shënuan ndaj Serbisë. Ky festim u interpretua si një veprim provokues politik nga ana e serbëve. Shaqiri ka lindur në Kosovë, një shtet që e ka shpallur pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, megjithëse kjo e fundit nuk e njeh. Për këtë arsye, festimi i Shaqirit kishte pasoja politike të diskutueshme, jashtë fushës. Megjithatë, Liverpooli mund të tregojë kujdes dhe të vendosë kundër grumbullimit të tij në skuadrën që do të udhëtojë drejt Serbisë, pasi tensioni politik dhe pritja potencialiste e rënduar mund të jenë shumë të diskutueshme.

Drejtori sportiv i Crvena Zvezdas, Zvezdan Terziç, zbuloi se klubi i tij do të bëjë detyrën për ta mbrojtur Shaqirin, së bashku me Liverpoolin, megjithëse theksoi ndikimin e situatës. "Unë mendoj se Shaqiri do t'i nënshtrohet presionit të jashtëzakonshëm psikologjik", ka thënë Terziç për gazetën serbe "Kurir". "Ai e di se ku do të shkojë. E di mirë se klubi ynë është një simbol i Serbisë. Nuk e di nëse ai do të jetë i gatshëm të luajë në Serbi, në këto kushte, kështu që dyshoj se do të vijë. Ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi që Shaqiri të ndihet i sigurt për të luajtur futboll. Është detyra jonë ta mbrojmë atë". Ndonëse Xhaka kërkoi falje për festimin me "shqiponjë", Shaqiri mbeti disi i patundur nga kjo gjë. "Sigurisht, kërkoj falje nëse njerëzit ndihen të sulmuar në Zvicër", ka thënë Shaqiri. "Dikujt, nuk e di, ndoshta në male, ku dikush e ndiqte lojën dhe shqetësohej, me siguri do t'i kërkoj falje".

# Formula 1 në Danimarkë, gara 'digjet' pa nisur



KOPENHAGËN, 21 SHTATOR - Danimarka ka hequr dorë nga planet për të organizuar një garë të Formula 1 në Kopenhagën, ka deklaruar këtë të premte ministri i financave, Kristian Jensen, i cili bëri me dije se vendimi për t'i ndalur planet për zhvillimin e një Çmimi të Madh në kryeqytetin danez në vitin 2020 ka ardhur për shkak të mungesës së mbështetjes nga autoritetet e qytetit. Ideja për një garë në Kopenhagën lindi në korrik, kur një grup financiar i udhëhequr nga biznesmeni i fuqishëm danez Lars Seier Christensen propozoi një garë në rrugët e qytetit.

Propozimi u pranua nga inxhinieri i plotfuqishëm në Formula 1, Hermann Tilke, ndërsa cirkuiti planifikohej të kishte një pistë prej 4.5 kilometrash, duke përfshirë një kthesë përballë parlamentit, një pjesë të drejtë ku shpejtësia arrinte 300 km/orë mbi urën Knippelsbro dhe një pjesë tjetër të shpejtë në rrugën Slotsholmsgade, pas bursës së qytetit. Një plan i bukur, me një pistë që do të kishte pjesë ku arrihej shpejtësia maksimale e makinave, ndërthurur me pjesën ku duhej vetëm teknikë dhe aftësi maksimale e pilotit. Për fat të keq, Bashkia e Kopenhagenit vendosi të mos jepte asnjë ndihmë financiare për këtë projekt dhe kjo ka bërë që qeveria të tërhiqet, duke refuzuar t'i marrë përsipër të gjitha shpenzimet.

## SHKURT

### Ozili për Xhakën është njëshi i futbollit

Mesfushori shqiptar i Arsenalit, Granit Xhaka, e ka lavdëruar bashkëlojtarin e vet, Mesut Ozil. Xhaka konfirmoi se ish-reprezentuesi gjerman është lojtari më i mirë me të cilin ka luajtur deri tash. "Mendoj se Ozili është lojtari më i mahnitshëm që kam luajtur deri më sot", ka thënë Xhaka për "Sky Sports".

### Basha kritikohet nga mediet greke

Edhe pse ka qenë një lojtar shumë vendimtar në ndeshjet që Kombëtarja Shqiptare zhvilloi në kuadër të Ligës së Kombeve, Migjen Basha nuk është duke kaluar një formë të mirë në Greqi. Mediet greke e kanë vendosur lojtarin në qendër të kritikave madje shkruajnë se lojtari mund të ulet në stol nga trajneri Pako Herrera. Sipas tyre, mesfushori kuqezi ka bërë shumë gabime dhe kjo e ka lëkundur pak trajnerin Herrera. Megjithatë, lojtari do të ketë edhe një shans të fundit për ta bindur trajnerin në stërvitjen e radhës.

### Aguero vazhdon kontratën me Cityn

Skuadra kampione e Premierë Ligës, Manchester City, ka bërë me dije se sulmuesi Sergio Augero ka nënshkruar kontratën e re me klubin. Me kontratën e re trevjeçare argjentinasi synon të kalojë dhjetë vjet te klubi anglez tek i cili ka realizuar 204 gola në 299 paraqitje dhe është golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve te kampioni aktual. Aguero në Manchester City u transferua nga skuadra e Atletico Madridit.

### Totti: Ja pse mora kartonin e kuq ndaj Balotellit

Ish-kapiteni i Romës, Francesco Totti, ka folur për kartonin e kuq që e kishte marrë në ndeshjen finale të Kupës kundër Interit, pas një reagimi aspak sportiv ndaj Mario Balotellit. "Ishte një finale ku më provokuan, më fyen mua dhe romakët. Ishte një sulm i vazhdueshëm. Në fund, situata shpërtheu… Ishte një faull i tmerrshëm, vetëm për ta lënduar atë, por lojtarët e Interit nuk më sulmuan. Ndërsa po largohesha pas kartonit të kuq, Maicon më dha kurajë. Ndjenja është se edhe në mesin e shokëve të tij, Balotelli krijoi acarim", ka thënë Totti.

### Lopetegui: Modriqi është lojtari më i mirë në botë

Luka Modriq është lojtari më i mirë në botë për momentin. Këtë mendim e shpreh trajneri i Real Madridit, Julen Lopetegui. "Unë nuk e përkrah shumë lojën individuale sepse e shoh futbollin si një sport kolektiv. Unë do të doja që topi i artë të fitohet nga lojtari ynë, Modriq, i cili ka bërë një vit fantastik. Ai është më i miri në botë për momentin", ka thënë Lopetegui.

### Aubameyangi: Arsenali mund ta fitojë Evropa Ligën

Sulmuesi Pierre-Emerick Aubameyang shënoi dy gola në ndeshjen e parë të Evropa Ligës kundër Vorskla Poltavas, kurse është shfaqur optimist se Arsenali mund të triumfojë në këtë garë. "Jam shumë i lumtur që jemi përsëri në këtë garë dhe ne e synojmë finalen, natyrisht. Mendoj se luajtëm mirë në fillim të pjesës së parë dhe në fillim të së dytës. Ne shënuam katër gola", ka thënë Aubameyang.

# ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 te Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik. Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

## KONKURS

### Asistent/e Administrativ/e pranë zyrës së Kryetarit

**Numri i pozitave: 1** (një vend pune),

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
- Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korespondencën, raportet, memorandumet dhe e-malit për mbikëqyrësin;
- Pranon dhe shpërndan korespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit;
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
- Pranon palët për Kryetarin e OMK-së dhe udhëheqësit tjerë të Odës, orienton palët te personat kompetent; dhe
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

**Shkollimi i kërkuar:** Diploma e Shkollës së Mesme, e preferueshme në vitin e fundit të studimeve universitare

**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Së paku 1 vit përvojë pune;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi, etj;
- Aftësi në menaxhimin e zyrës së Kryetarit të OMK-së dhe koordinimin me njësitë e OMK-së;
- Aftësi për të kuptuar informacionin në mënyrë të shpejtë, të arrijë të kyçet në tema dhe çështje, dhe të përcjellë në mënyrë efektive informacionet e ndërlikuara;
- Të ketë aftësi të punës ekipore dhe aftësi për të krijuar raporte pune ndër personale të shkëlqyeshme;
- Shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me gojë dhe shkrim;
- Të jetë energjik/e, të jetë i/e gatshme të punojë nën presion dhe me orar fleksibil të punës;

### Asistent/ e Ligjor/e për Komisione të Përhershme të Odës

**Numri i pozitave: 1** (1 vend pune),

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

- Përgatit dhe asiston në përpilimin e akteve juridike për nevoja të Odës;
- Ndërmerr veprime të nevojshme për ekzekutimin e akteve në asistencë të Zyrës Ligjore të Odës;
- Merr pjesë në mbledhjhe të organeve të Odës, veçanërisht në mbledhje të Komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës në mbledhjet e tilla;
- Mban evidencën e mbledhjeve të Komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera kur kjo kërkohet nga ai/ajo;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërlidhen me vendimmarrjen e komisioneve të përhershme të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera sipas nevojave të organeve të Odës, Zyrës ligjore dhe Shërbimit Profesional në përgjithësi.

**Shkollimi i kërkuar:** Ta ketë të kryer shkollën e mesme, përparsi konsiderohet shkollimi superior.

**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi, etj;
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Së paku 1 (një) vitë përvojë pune në profesion.

### Asistent/e Administrativ/e për Komisionet e Përhershme të Odës

**Numri i pozitave: 1** (1 vend pune),

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ofron asistencë në kryerjen e punëve administrative për nevojat e punëve të Komisioneve të Përhershme të OMK-së;
- Pranon aplikacionet, kërkesat/ankesat nga palët drejtuar Komisioneve të Përhershme, kujdeset për mbarëvajtjen e procedurës administrative deri në shqyrtimin final të lëndës;
- Mirëmbanë dosjet, në formën fizike dhe elektronike si dhe data bazën e Komisioneve të Përhershme;
- Siguron materialet e nevojshme për mbarëvajtje të mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme;
- Ndihmon anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet të tjera të OMK-së si dhe palëve të treta;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara me Kontratën e Punës.

